

Dukagjini "Nderi i Kombit"



Dukagjini

Botim Periodik i Shoqatës Atdhetare "Dukagjini", Viti i XVII i botimit, nr. 196, Shkurt 2020
Nr. Llog. UNIONBANK 510367047020112, Shkodër - Albania, Tel. 00355674001940, internet: www.shoqatadukagjini.com, Kryeredaktore: Suela Ndoja, Çmimi 30 lekë / 1.5 euro

ISMAIL KADARE I PËRKET BOTËS LETRARE NDËRKOMBËTARE 6

Në 84-vjetorin e tij të lindjes, Akademia e Shkencave mblodhi tryezën "Kadare dhe letrat shqipe", ku ka ripropozuar shkrimtarin Ismail Kadare për çmimin "Nobel", Akademisë së Shkencave të Suedisë. E përshëndes me entuziazëm këtë nismë pozitive, por do të dëshiroja që kjo të mos mbetet vetëm në këtë ditë, por të bashkoheshin bashkëbesëlidhësit në Shqipëri, Kosovë dhe diasporë për ta finalizuar atë.

Ditëlindja e Ismail Kadaresë është nuk është një datë e shënuar vetëm për lexuesit shqiptarë që krenohen me të, por edhe për lexuesit e gjuhëve të tjera në botë, pasi letërsia e tij është përkthyer në më shumë se 45-së gjuhë. Kadare ka qenë disa herë kandidat për çmimin "Nobel" në letërsi dhe së fundmi ka marrë dekoratën më të lartë franceze, më 1 janar 2020, nga presidenti i Francës, Makron "Oficer i Madh i Legjionit të Nderit".



"TRE TË SHOSHJANËT"

Me datën 15 shkurt 2020, në mjediset e bibliotekës së qytetit "Marin Barleti", Shoqata Atdhetare "Dukagjini" në bashkëpunim me Shoqatën e shkrimtarëve Shkodër, dhe bibliotekën "Marin Barleti" organizoi ceremoninë për paraqitjen e librit "Tre të Shoshjanët", të autorit At' Daniel Gjeçi.

Në këtë ceremoni morën pjesë shkrimtarë, poetë, historianë e dashamirë të librit.

Ceremoninë e hapi kryetari i shoqatës atdhetare "Dukagjini", Ndue Sanaj, i cili pasi i uroj mirë se ardhjen të pranishmëve, theksoi: "Kënaqësi, që jeni bërë pjesë e një paraqitje të librit, me titull "Tre të Shoshjanët"-Besa-, me autor At' Daniel Gjeçi, i botuar në Romë, në vitin 1999, nga një personaliteti jo vetëm në fushën klerikale, të gojëtarisë e të letrave, por dhe të publikimit të vlerave të banorëve, të familjeve dukagjinase për virtytet jetësore të tyre, mbi bazën e të cilave kanë mbi jetuar në s



2

KORONAVIRUSI?: MUND TË JETONI DUKE NDJEKUR FRIKËN OSE DUKE PASUR BESIM NË JETË!



12

“TRE TË SHOSHJANËT”

Me datën 15 shkurt 2020, në mjediset e bibliotekës së qytetit “Marin Barleti”, Shoqata Atdhetare “Dukagjini” në bashkëpunim me Shoqatën e shkrimtarëve Shkodër, dhe bibliotekën “Marin Barleti” organizoi ceremoninë për paraqitjen e librit “Tre të shoshjanët”, të autorit At’ Daniel Gjeçi.

Në këtë ceremoni morën pjesë shkrimtarë, poetë, historianë e dashamirë të librit.

Ceremoninë e hapi kryetari i shoqatës atdhetare “Dukagjini”, Ndue Sanaj, i cili pasi i uroj mirë se ardhjen të pranishmëve, theksoi: “Kënaqësi, që jeni bërë pjesë e një paraqitje të librit, me titull “Tre të Shoshjanët”-Besa-, me autor At’ Daniel Gjeçi, i botuar në Romë, në vitin 1999, nga një personaliteti jo vetëm në fushën klerikale, të gojëtarisë e të letrave, por dhe të publikimit të vlerave të banorëve, të familjeve dukagjinase për virtytet jetësore të tyre, mbi bazën e të cilave kanë mbi jetuar në shekuj.

Kjo vepër është botuar nga biblioteka françeskane “At’ Gjergj Fishta”, e cila ka meritën e veçantë. Por dhe nën kujdesin e studiuesit, poetit e publicistit Prelë Milani. Të dy palët i falënderojmë!

Kjo vepër është e ndarë, po të thuash në dy pjesë:

Pjesa e parë, përmban kohën dhe kushtet politike e sociale, që çuan banorët e Dukagjinit, të Malësisë së Madhe, të Pukës e të Mirditës në kryengritjen anti-Zogiste, si dhe shkaqet e dështimit të saj, që besoj se për gjithë pjesëmarrësit është e njohur.

Pjesa e dytë, përshkruhet një nga virtytet më madhore shqiptare, por në veçanti të banorëve të maleve, BESA

Besa, ky institucion popullor ka mbajtur gjallë jetën e malësorëve, e cila është e ligjruar në kanunin “Leke Dukagjini”,



pa të cilën nuk mund të ecet. Në shtetin ligjor është fjala e pas saj shkohet te noteri e me radhë në institucionet e drejtësisë; ndërsa në kohën pa shtet ka qënë fjala e dhënë, ose më mirë, siç është theksuar e

theksohet “Besa”. Kjo Besa, është e personifikuar në këtë libër, nëpërmjet personazheve real, Mark Milani, Babun Celi e Zef Delia. Këta dukagjinase duke i ndenjur besnik fjalës së dhënë njeri-tjetrit u varen


nga regjimi i Zogut. Ky qëndrim i tyre nuk ishte rastësisht, por ishte një formim i tyre brez pas brezi me këtë ndjejnë bese reciproke në mes banoreve të tyre”.

Pastaj përshëndeten të pranishmit shkrimtari Ndrek Guri. Në emër të shoqatës “Besa”, përshëndeti Gege Zefi. Në emër të shoqatës atdhetare “Malësia”, përshëndeti Ilmi Kurti. Në emër të shoqatës “Nikaj-Merturi”, përshëndeti N/koloneli në rezerve Dede Zhivani. Gjithashtu përshëndeti Zef Bari, banor i fshatit Thethi, të vendlindjes së At’ Danielit, dhe në emër të familjes së At’ Daniel Gjeci, përshëndeti nipi i tij, Gjelosh Luca.

Mbi veprën e At’ Danielit “Tre të shoshjanët”-Besa, dhanë opinione poeti Lazer Kodra, përkthyesi Zija Vukaj, kritiku Kadri Ujkaj, mësuese e anglishtes Vitore Kodra, krijuesi Kadri Fikaj, Donatela Guri, poeti Luash Brigja dhe Luigj Shyti.

Mbylli këtë ceremoni poeti, studiuesi e publicisti Prele Milani.

Korrespondenti i gazetës “Dukagjini”



AT DANIEL GJEÇAJT I JEMI BORXH

Ditët e fundit u ndodha në një librari në një nga rrugët e qytetit dhe me ra në sy libri “Tre të Shoshjanët, Besa” të autorit At Daniel Gjeçaj. E mora menjëherë dhe e lexova me një frymë. Përpara syve të mendjes, si në një film, mu projektuan ngjarje të atyre viteve sikur ti kisha përjetue vetë. Ky libër me kujtime historike të letrarizuara, ashtu siç dinte ta bënte At Danieli, me atë pendën e tij të hollë, mbështetur në gjuhën e bukur që përdorin malësorët prej nga është, të rrjedhshme dhe plotë krahasime shumë të bukura e të thella, të cilat e bëjnë edhe më tërheqës këtë libër jo voluminoz për nga madhësia, por voluminoz dhe të thellë në mendime, në histori, e të shtrirë në kohë.

Besa është karakteristikë e shqiptarit në tërësi, por për malësorët, si në këtë rast, është veçori besa për mikun, për shokun, për të mos e lënë ortakun, bashkëluftëtarin, bashkëvuajtësin të bjerë në dorën e armikut, qoftë edhe i plagosur dhe i pamunduar për të ecur vetë. Besa bëri që tre shoshjanët të shkonin në litar. Ky është heroizëm vullnetplotë, sepse i kishin dhënë besën njëri tjetrit për të mos lënë prapa asnjërin në çdo rrethanë. Dhe ora e deshi që Zef Delia të plagosej rëndë, por shokët nuk e lanë për asnjë moment vetëm, pranuan që të flijoheshin edhe vetë, por besën mos ta thyenin, mos ta shkelnin. Akti i tyre është dhe mbetet shembull për brezat, për besnikëri, është faqebardhësi e shtëpisë, fisit e krahinës.

Vjeshta e vitit 1926 dhe viti 1927 qenë për Dukagjinin koha e një reprezalje të pa parë në historinë e kësaj zone, por edhe shumë më gjerë. Natyrisht, ky botim, i shkruar në vitin 1999, përbëhet nga kujtime të autorit, ndonëse ishte i vogël në moshë, por shumë i zgjuar dhe i kujdesshëm se çfarë po ndodhte në Shqipëri, në Dukagjin dhe pa tjetër edhe në Thethin e tij të dashtun dhe gjithmonë të pa harrueshëm. Këto kujtime pa tjetër që janë freskuar dhe pasuruar në biseda në kullat malësore, për veprimtarinë e Qeverisë së Zogut, në kujtesën e familjarëve të tij të zgjuar, bashkëkohës të atyre bëmave të xhandarëve, e qeveritarëve, etj. Lëvizja e Dukagjinit nuk ishte e suksesshme, por gjithsesi tregoj se populli po vuante, populli kërkonte më shumë liri e përparim. Ajo tranditi shtetin e kohës, por ai u vërsul egërsisht, në mënyrë të pamëshirshme, duke vrarë, duke burgosur, duke plaçkitur, duke djegur dhe rrënuar çafërë u dilte përpara.

Këto kujtime të shkruara nga At Dan-



iel, janë një kujtesë e fuqishme, janë një pengesë në rrugën e harresës së historisë, për të cilat kemi nevojë, sepse ai popull që harron të kaluarën historike, ka rrezik që në një formë ose një tjetër, të përsëritet historia. Ata që dinë kush janë e nga vinë, dinë ku shkojnë e çfarë kërkojnë.

At Daniel Gjeçaj, me punën e tij, me shkrimet e kujtesës e tij ka hyrë në histori, dhe ne jemi borxhëlinjë të tij. Ne na bie detyra që të kujtojmë martirët si At Danjeli. Përsërisht e përgëzoj Prelë Milanin i cili e gjeti në arkivën e At Danielit këtë material, e mori dhe e botoi. Vërtetë heronjë e këti libri janë të afërmë të Prelës apo edhe të shoshjanëve të tjerëve, por

veprimtaria e tyre, trimëria, besa e tyre, kanë nderuar gjithë Dukagjinit, prandaj ata nuk u përkasin vetëm pasardhësve të tyre, por gjithë Dukagjinin e më gjerë. Në këtë vështrim unë nuk e konsideroj aspak punën e Prelës si personale dhe vetëm për lavdinë e familjës së tij apo shokluftëtarët e Mark Milanit. Ky botim lartëson këta heronjë që paraqiten brenda tij, por ngre lart dhe nderon atë lëvizje dhe të gjitha ata që u rreshtuan në të, në nëntorin e 1926.

Atë Danieli e shkroj këtë libër në vitin 1999, që përkon me afrimin e fundit të jetës së tij. Duket se e quante një detyrë, një borxh, që të tregonte, në mënyrën e tij, për atë ngjarje të jashtëzakonshme

të atyre viteve, dhe arrinë të na e japë të gjallë, të fortë, dhe në pak faqe të shkruaj historinë e asaj ngjarje të përgjakshme për Dukagjinin.

At Danieli meriton dhe duhet të vlerësohet nga Thethi, nga Dukagjini, por edhe nga shteti, si meshtar e di propogadues i fesë, si intelektual, si botues e propagandues i vlerave krahinore e shqiptare, si luftëtar i paepur kundër rregjimit komunist, etj. Mendoj se jemi të vonuar në këtë drejtim, prandaj po përsërite në këtë promovim një propozim që e kam bërë disa kohë më parë, madje në rrethe të ngushtë edhe prej disa vitësh. Ky françeskan i devotshëm për besimin fetar, por edhe më gjerë, kjo figurë e historisë, dhe e kulturës, për këtë njeri të madh dhe të veçantë, të ngrihet një dhomë muze në Theth, në shtëpinë ku ai u lind dhe të cilin nuk e harroj kurrë. Natyrisht kjo kërkon një projekt të menduar mirë, një bashkëpunim me familjarët e tij në Theth apo kudo ku jetojnë, që, bësoj se do të jenë të gatshëm, me bashkëpunëtorët e At Danielit, me bashkëkrahinarët e bashkëatdhetarët brenda dhe jashtë atdheut, me bibliotekën françeskanë në Shkodër, Ipeshkëvinë Shkodër-Pult, arkivat dhe muzeun dioçezan, arkivat shtetërore në Shkodër dhe në Tiranë, me organet e pushtetit vendor dhe qendror, mbledhjen e përpunimit e kujtimeve të bashkëkohësve, bashkëpunëtorëve, bashkëpunim me historianë dhe studiues, gazetarë, studimin e kujdesshëm të arkivit dhe bibliotekës së tij, etj. Unë e shikoj shumë të mundshme, në të gjitha drejtimet, ngritjen e kësaj pike kujtese në vendlindjen e tij, e cila do të shërbejë kujtesës për At Danielin, do ti shërbejë të afërmeve të tij kudo që janë, do ti shërbejë Thethit, Dukagjinit, Shkodrës dhe Shqipërisë, do ti shërbejë historisë dhe kulturës tonë, do ti shërbejë edhe turizmit e perspektivës së tij. Kapacitetet organizative, mundësitë e ambjenteve, mundësitë materiale, mundësitë dokumentare, etj, janë për tu arritur. Natyrisht, pa tjetër që kërkohen edhe mjetë financiare. Unë mendoj se do të gjenden njerëz vullnetmirë për të realizuar këtë objektiv sa të bukur aq edhe i vlefshëm. Pa ja nis nuk bëhet asgjë.

Do të ndjehesha shumë i kënaqur po të realizohet kjo ide, në kujtim dhe si një pengesë në rrugën e harresës për këtë frat të përkushtuar, të këtij bashkëfshatari tim të vyer dhe të pavdekshëm nga punën e tij të madhe.

Duke përfunduar i them sinqerisht Prelë Milanit: “Të lumtë”.

Luigj SHYTI,
me 15 shkurt 2020

BINOMI I SPIKATUR LUFRARAK BABUN CELI E ZEF DELIA

Lulash Brigja

Janë një binom fatosash të dliirë të pa shoq të kohës kur jetuan, që të dy linden Shosh Babun Celi me 1883, në Celaj ndërsa Zef Delia 1895 në Prekal.

Ata kishin tiparet autentike mashkul-

lore alpine, të gjatë dy metrosh të hajm në fytyrë të fuqishëm si qe. Nga karakteri të çelikle, por te urte te matur që nuk dinin të ndanin fjalët nga vepra: Babuni duke qenë më pjekur në moshë kishte marre pjese në kuvende rrafshi e pleqni më burrat më rafinuar te kohës. Kishte një kullë

13 pash në krye te një are 25 argatësh që syzohej me shenje në gjithë Shosh.

Me Zef Delinë miqësinë e betonuan më 1910 në Qafen e Agrit në ndeshje, kundër Shefqet Turgut Pashës në Kryengritjen e Malësisë së Madhe me 1911 përkrah Dede Gjon Lulit e Mehmet Shpendit ash-

tu edhe kundër Veshoviqit të Malit të Zi në vitin 1915 në qafen e Boshit. Në vitin 1918, së bashku me Dedë Nduen, Ukë Stakën e 30 burra të tjerë, nga Shoshit, kryen një aksion për nxjerrjen e armëve që kishin strehuar italianët në ambientet e Kishës së Shoshit. Babun Celi dhe Zef Delia kanë gene nga luftëtarët më aktiv të kryengritësve të Shoshit, Shalës që në mbrëmjen e 29 majit 1924 kur sulmuan e morën qendrën e rrethit në Kodër Shëngjergj dhe me 31 maj sulmuan e rrethuan komandën e Qarkut të Shko-

JETËSHKRIM I SHKURTËR I MARK MILANIT DERI NË MOMENTIN E FLIJIMIT HISTORIK!



Vitore Kodra

Mark Milani lindi me 1890 në Pepsumaj. Ishte djali I vetëm që i mbijetoj Milan Çunit të Shoshit. Që kushëri në tre brez i Lulash Balës dhe nipi i Vuk-san Nike Lules Palajve, që te dy të internuar dhe vdekur në Kerr Torobullus nga turqit, në vitin 1872. (AQSH.F.Nr.3.1930 D.Nr.4).

Në ndryshim nga Babun Celi dhe Zef Delia ishte meso burrë nga shtati, faqe kuq, flokë gështenjë. Në fizionomi mori më shumë nga nena, në temperament dhe karakter më tepër nga baba. I qete pa rrebe, zemërhapur, pune mirë. I vendosur e stoik si ai.

Në korrik të vitit 1910 luftoi kundër Tugut Pashës, qe pjesëtar i forcave dukagjinase në kryengritjen e Malësisë së

Madhe me 1911, u shqua gjithashtu edhe në luftën kundër Malazezve në vitin 1915 në qafen e Boshit, duke qene dëshmitar i tre betejave historike që shkruan me gjak malet e Dukagjinit. Në vitin 1910, kur Turqia shpalli konstitucionin për të gjitha kombet që kishte nen sundimin e vet, mori pjese mes përfaqësuesve të një suite të madhe të Shoshit, në manifestimin e madhe popullor që u organizua në kështjellën e Shkodrës. (Zef Harapi "Dukagjini në dokumente historike" A.M.H. Shkodër. F. 174.) Mark Milani së bashku me Babun Celin, Zef Deline, Uke Staken, Ded Ndoun e Mark Ndoun, qene përkrahës të Princ Vidit dhe të thirrur nga Ndoke Gjeloshi kane luftuar për mbrojtjen e tij nga sulmet e forcave rebele turkomane të Shqipërisë së mesme. Po kështu edhe kur në Shkodër plasi një sherr i madh banal mes "Mallatares së kapelës" dhe "Sorrës së flamurit". (shkruan Sejfi Vllamasi në librin e tij "Ballafaqimet politike në Shqipëri" 1912-1939, fq 133). Në vitin 1918, Mark Milani së

bashku me 30 burra të tjerë nga Shoshi, kryen një aksion për nxjerrjen e armeve që kishin strehuar italianet në ambientet e Kishës së Shoshit, duke dite se prifti (Patër Pali) konsidero-

hej si person i paprekshëm sipas Kanunit. Aksioni nuk ishte kundër kishës së shenjte, por kundër të huajve që kishin dhunuar shtëpinë e Zotit. Në ditët e para të qershorit të vitit 1923, së bashku me Babun Celin, Zef Deline, Vuksan Leken dhe disa vullnetare të tjerët të Shoshit ballafaqohen për 4-5 ore me pushke me forcat operationale të Prenge Jakut, që kishin si drejtim lëvizje rrugën Mali Shoshit-Kodër Shëngjergji (A.Q.SH.Fondi 252 dos. Nr 4.12 dt.07.06.1923). Në zgjedhjet elektorale të vitit 1923 përkrahu pa rezerva Luigj Gurakuqin, i cili kandidoi (dhe fitoi për opozitën). Në Dukagjin Mark Milani së bashku me Babun Celin kane qene shoqëruesit më besnik të tij (citon Mark Bregu në librin "Arbëria ime shkrime historike publicistike Tirane 2006. Fq 135).

Mark Milani ka qene një nga luftëtarët e vendosur të kryengritësve të Dukagjinit që në mbrëmjen e 29 majit 1924, kur u sulmua dhe u mor qendra e rrethit në Kodër Shëngjergj në Dukagjin. U shqua

për sulmin e furishëm mbi Prefekturën e Shkodrës, natën e 31 majit (Camillo Libardi "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu", Tir. Botim i vitit 1912, fq 34.)

Luftimet vazhduan gjithë natën dhe në orët e para të mëngjesit nga Gjelosh Marku i Shalës u vra Komandanti i Qarkut, Ferit Frasherit, i cili vazhdonte të qëndronte trimërisht. Vrasja e Ferdit Frasherit shënoi marrjen e Prefekturës Shkodër, ndërsa me datën 8 qershor 1924, Mark Milani së bashku me shokët e tij kryengritës të prire nga Ndoke Gjeloshi, në orën tre pas mesnatë vazhduan sulmin drejt Lezhës, luftimet qene të ashpra, zgjaten 4 ore dhe përfunduan me fitoren e kryengritësve, 13 vullnetare gjeten vdekjen dhe 6 të tjerë u plagosen (Gazeta "Ora e Maleve", 16 qershor 1924). U shqua si eksponent i veçante i kryengritjes anti-zogiste të nëntorit 1926, ai së bashku me Zef Deline nga Prekali dhe Prele Ndoke nga Pepajt, këputen linjën telefonit një nate para se të fillonte Lëvizja e Dukagjinit. Pas kryengritjes u arratis dhe u dorëzua në bese të Hasan Bek Bushatit, i cili e dërgoi përpara gjyqit politik duke u mburrur së bashku me dy shoqëruesit e Luigj Gurakuqit, i kishte kapur në male.



drës. Luftimi qe i ashpër dhe përfundoi me vrasjen e Komandantit të Qarkut. Babun Celi ishte bërë i njohur për trimëritë e tij në qytet dhe jashtë tij që në kohën e dauletit. Që në moshën 17 vjeçare në mes të Pazarit të Shkodrës theri një armik të i cili i kishte vrrarë një mik Me një lëvizje të dorës i kishte pre korditën arterien që çon gjakun në kokë, ndërkohë që me gjakftohtësinë më të madhe, mbështjedhur poshtë një manteli të zi holli thikën dhe u përziej me turmën shkruan Kamiljo Libardi në kujtimet veta historike duke vizatuar saktësisht atë qe kujtesa popullore ruan me besnikëri për ketë homerik te maleve të kanusë.

Natën e 19 nëntorit 1926 Babun Celi dhe Kryeparikët e Dukagjinit iu patën drejtuar Nënprefektit Lin Delia, në Kodër Shëngjergji duke i thënë:

- Populli është krijues në këmbë kundër Presidentit të tjera nuk e do. Merr xhandarët postës dhe nëpunësit e Rrethit dhe nisu për në Shkodër. Jeni në besën e njohur. Dhe askush nuk do guxojë tu dali do tu japësh armët si tu burrëroj Kështu u nis për në Shkodër Nënprefekti Lin Delia dy orë para agimit të 20 nëntorit 1926 i botuar nga Pjetrush Ndoja, i cili e përcjellë kështu dhe e plotëson deri në Urë të Sh-

trenjte Camillo Libardi. "Si u bë mbret i Shqipërisë Ahmet Zogu", Tir bot i 1912, fq 78

Kur u rrethua Poskomnda e xhandarmerisë tek Ura me mesit pas luftimeve te ashpera nga brenda dhe dëgjua thirrja në dore tendë, e të zotit Vas Kiri. Ky që thirri zyrtar Fiqir Dinja ZV / Komandanti i Xhandarmerisë shkruan në kujtime te veta Kamiljo Libardi "Errësira mbrojtja dhëne dhe rruga është e mundur me hy në gjytet, ku s'kish si duhet qeveritare. Po çuditërisht, ata qëndrojnë në vend. Ndoshta ata prisnin që të ngrihej qyteti. Në anën tjetër, posta e xhandarmeria, mua 3-4 vetë të parisë së Shkodrës dhe Zv Komandantin e Xhandarmerisë Fiqiri Dinën vazhdojnë qëndresën. Më në fondin e biseduar për dorëzimin e tyre. Merret veshin vetëm brenda disa paria e Shkodrës. Ndalet pushka dhe vendosja me i referohen të gjithë në Shkodër Në këtë koment një xhandar gjuan e vret nga brenda portës djalin e Vojvodës së Shalës (Kolë Binakun) që aktuale ishte afër portës Ky i kësaj duke thirre "më prenë në besë", "done me sulmue kullën". Malësorët ndahen në dysh, pro dhe kundër. Atëherë Babun Celi dy burra me autoritet, hidhen në mes e deklaruan: "Këtu

krijon paria e Shkodrës. Ata që kanë të bëjnë me ta, mund të bëjnë me ne "Kërko fashitet promovimin dhe paria bashkë me xhandarët dhe Fiqiri Dinën përcjellën për në Shkodër shendosh e mire të armatosur dhe pa u hyre ferrë në këmbë Ky fakt konfirmohet nga autoret (Kolonel Faik Quku "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore" fq 37 dhe Zef Harapi Dukagjini, historia dhe etnografia Studime 1940, fq 218)

Hasan Bek Bushati një nga eksponatet kryesor te ekspeditës ndëshkimore të forcave Zogiste në Zonë e Shoshit, u ngriti një pusi tipike besuarve dhe patriotëve të njohur Mark Milani, Babun Celi dhe Zef Delia: -Hajde e dorëzohuni në besë të Zotit dhe timen, se jam nga dera e pare e Bushtlive të Shkodrës . Zogu ka nxjerrë faljen për të gjithë kryengritësit dhe unë hy garant qoftë për jetën tuaj, qoftë se nuk do ju keqtrajtoj kurrkush, madje edhe ne burg vetëm pak dit do të rrini. I besuan Hasan Begut dhe gabinin fatal e paguan me jetën e tyre. Ja ku i keni gjakataret kanë dashur të përmbysin regjimin. Ja ku i keni shoqëruesit e Luigj Gurakuqit, rrethuesit Rrethit të Dukagjinit, Postkomadës së Mesit Prefekturë Shkodër dhe rebelet e peshkopit rebel Fan Noli. Ja ku i keni nxitësit dhe organizatorët e trazirave në malësi unë i kapa ne shpellat e malësisë dhe i solla përpara këtij gjyqi të ndershëm që të marrin dënimin e merituar. Ku e ke besën o Hasan Begu?!Ti na thirre ne besën të Zotit dhe tënden. Si nuk të skuqet fytyra e thua u kapa ne male. As ti bek as 100 si ti, sikur të mos dorëzohemi burrnish ne besën tanë nuk do mun të na kishit kapur kurrë, Ti po rrën vetë me i hy në qef qeverisë me të dhanë ndonjë grade, por ti gradat i mbaj me turp e faqe te zeze, qe reagimi i Babn Celit e Mark Milanit nga banka e te akuzuarit sy ndër sy ndaj dëshmitarit mburracak dhe të pa burrin Hasan Bek Bushati.

Babun Celit i hedhin barë gjumi për ta zaptuar

Babun Celi mbahej në një qeli të veçantë, Çun Sokoli në një tjetër, ndërsa Mark Milani, Zef Delia dhe Martin Marashi ishin bashkë në një qeli treshe. Ndërkohe që Babuni me shokë priste me ankth ditën e ekzekutimit, ata të parisë së Shkodrës që kishin qene te rrethuar tek Ura e Mesit (Muharrem Kazazi, Man Hoti dhe një tjetër me mbiemrin Lluja të cilët i patën ndërhy e shpëtua në besë Babun Celi dhe Mark Milani), shkuan në Tiranë dhe i luten Presidentit Zog për faljen e tyre, për çka marrin edhe premtime. Me gjithë këtë, mbas një muaj, Presidenti dekreton zyrtarisht ekzekutimin e tyre. Babun Celit ia kishin frikën se ishte i fuqishëm sa dy burra dhe i gjatë sa një lis, prandaj gjatë shoqërimit për në vendin e ekzekutimit, nga zemërimi mund te copëtonte rojet e togës së shoqërimit. Për të parandaluar ndonjë incident te tille, atij i jepet ushqim të përzier me barë gjumi, me qellim qe të vihej në gjumë. Kështu u bë.

Babun Celi, gjoja i prekur nga një sëmundje e papritur dhe e panjohur, e veçojnë gjysme të vdekur në një qeli tjetër. Aty e lidhën për duarsh, për këmbesh dhe rreth trupit si një foshnje në djep me litar të trashë. Ndërsa në momentin kur Babun Celin e nxorën nga dera e oborrit të Kaushës për ta nisur se bashku me shokët atje ku e priste litari të cilin një erë e ftohtë e lëvizte si lavjerrës, njeri nga xhandarët u soll në mënyrë brutale kur kronometri po regjistronte minutën e fundit të jetës së këtij vigani. Xhandari e shtyu aq fort sa Babuni për pak sa nuk u rrezua. Atëherë i prangosuri u kthye në mënyrë të rufeshme dhe me forcën e një kali arab e shqelmoi me këmben e djathtë xhandarin duke e rrëzuar si thesin për tokë dhe ju vërsul përsipër si luani duke e kafshuar me dhëmbë pasi duart i kishte të lidhura

(Përfundon rrëfimin e tij Kolonel;-Faik Quku në kujtimet tija "Qëndresa shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore". fq 37).

ISMAIL KADARE I PËRKET BOTËS LETRARE NDËRKOMBËTARE

Në 84-vjetorin e tij të lindjes, Akademia e Shkencave mblodhi tryezën “Kadare dhe letrat shqipe”, ku ka ripropozuar shkrimtarin Ismail Kadare për çmimin “Nobel”, Akademisë së Shkencave të Suedisë. E përshëndes me entuziazëm këtë nismë pozitive, por do të dëshiroja që kjo të mos mbetet vetëm në këtë ditë, por të bashkoheshin bashkëbesëlidhësit në Shqipëri, Kosovë dhe diasporë për ta finalizuar atë.

Ditëlindja e Ismail Kadaresë është nuk është një datë e shënuar vetëm për lexuesit shqiptarë që krenohen me të, por edhe për lexuesit e gjuhëve të tjera në botë, pasi letërsia e tij është përkthyer në më shumë se 45-së gjuhë. Kadare ka qenë disa herë kandidat për çmimin “Nobel” në letërsi dhe së fundmi ka marrë dekoratën më të lartë franceze, më 1 janar 2020, nga presidenti i Francës, Makron “Oficer i Madh i Legjionit të Nderit”.

Ismail Kadaré është një autor, puna e të cilit është po aq e papritur, sa një kohë ka qënë e pashpresë. Në një vend që ishte një nga më totalitarët në planet, në Shqipëri, ai arriti të ngrihet në rangun e shkrimtarit kombëtar, ndërsa krijoi një vepër gjithnjë e më kritike. Ismail Kadaré e bëri groteskun një armë jashtëzakonisht të efektshme, për të denoncuar diktaturën në Shqipëri. Puna e tij, megjithatë, nuk mund të kufizohet në denoncimin e totalitarizmit. Paradoksi është marramendës dhe nuk ka rreshtur të ketë dyshime të vazhdueshme për të. Sidoqoftë, duhet pranuar se autori zhvilloi një betejë autentike letrare. Në disa raste, ai u shqetësua seriozisht derisa, në kohën e dënimit, diktatori, Enver Hoxha, ndërhyri për të ndërprerë procesin ndaj tij. Shkrimtari ende habitet për këtë butësi të çuditshme. Kadaré ishte dhe mbetet gjithmonë një njeri i Iluminizmit dhe një humanist, një njeri i lirë dhe një demokrat i zjarrtë, i cili transmetoi përmes mesazheve të veprës së tij, për disa dekada, kushtet e tmerrshme të një diktature të tmerrshme. Drejtpërdrejt ose indirekt, ai transmeton mendimin e tij, ideologjinë e tij, dashurinë e tij për lirinë. Ndikimi i tij është i shquar në të gjitha aspektet e jetës, kulturës dhe identitetit shpirtëror të shoqërisë shqiptare dhe veçanërisht midis brezave të rinj.

Originaliteti i tij disidencial shfaqet qartë brenda veprës së tij: në shkrimet e tij, ai komunikon revoltën e tij në të gjitha vendet komuniste të Lindjes dhe ky veprim kërkon konsideratë të lartë dhe respekt të pakufishëm, sepse ky fenomen i rezistencës kulturore dhe ar-

tistike ishte mjaft i veçantë dhe i pashembullt në histori. Borgjezia Ndërkombëtare mbajti një heshtje të plotë dhe befasuese për fatin e shqiptarëve, të nënshtruar nga diktatura staliniste, ndërsa mbështeti me mjete mbresëlënëse lëvizjet disidente në vendet komuniste, si Bashkimi Sovjetik, Hungari, Çekosllovakia, Gjermania Lindore, etj.

Duke parodizuar Ferrin e Dantes, ai tregon, në “Muzgu i perëndive të stepës” (1978), neverinë e thellë që realizmi socialist frymëzoi në të. Shkrimtari konsideron se ai ishte imunizuar kundër kësaj doktrine falë modeleve klasike që ai nderon dhe me të cilat janë përvetësuar veprat e tij: Homeri, Eskili, Dante, Shekspiri, Cervantes, Gogol. Në vitin 1960, prishja me Sovjetikët e detyroi atë të kthehej në Tiranë. Fillon punë si gazetar. Fillon të shkruajë qysh në moshë të re, por në fillim botoi vetëm disa poema. Në moshën 13 vjeçare zbuloi Makbethin, një ndër veprat e Shekspirit, dhe kështu i lindi dashuria për letërsinë. Në këtë moshë shkroi tregimet e para të cilat i botoi te revista Pionieri në Tiranë. Më 1954 botoi një përmbledhje poetike të quaj-

disa tundime, Kadaré nuk pranoi ta linte vendin. Romani i tij paskëtaj, “Përbindëshi”, u kritikua së tepërmi kur u botua, në 1965, në një revistë letrare. Pasi u ndalua, ai u botua si libër para fundit të 1990, pas 25 viteve pritje.

Pasi u bë një shkrimtar me kohë të plotë, Kadaré drejton edhe revistën letrare “Les Lettres albanaises” (botuar njëkohësisht në frëngjisht). Pas dy vjet largimi në fshat, ai arriti të udhëtojë në Finlandë (1962), Kinë (1967) dhe Francë, për herë të parë, në 1970. Ismail Kadaré u emërua deputet, pa e kërkuar atë. Në 1972, atij iu desh të bashkohej me partinë, por një roman provokoi poshtërimin e tij. Ai u dërgua përsëri në fshat. Ai u ndalua të shkruajë një farë kohe. Librat e tij do të botohen në Francë nga Fayard. Pas zhgënjimit nga temat aktuale, u rikthehet temave historike. Në këtë kohë Kadare konsiderohej si shkrimtar i talentuar, por talenti i të cilit anonte nga dekadencia dhe subjektivizmi. Armiqtë e Kadaresë në organet e Sigurimit dhe garda e vjetër e Byrosë Politike e akuzonin atë vazhdimisht si «agjent i Perëndimit», që ishte njëra prej akuzave më të rrezikshme që mund

“Çlirimi i Serbisë prej Kosovës”, 1973, 1980, 1981...) nuk mori çmimin Nobel. Veprat e tij do të botohen pothuajse të gjitha, më shpesh duke shkaktuar heshtje nga kritika ose paralajmërime. Në disa raste, ai u kritikua ashpër: në 1973 (“Dimri i vetmisë së madhe”), në 1975 (për poezinë «Pashallarët e Kuq»), në 1982 (“Pallati i ëndrrave”), etj. Tek “Ura me tre harqe”, Ismail Kadaré vë shenjën e barazimit midis Orientit dhe despotizmit. Perandoria Osmane, trashëgimtare e tiranive të lashta, mishëron, për të, frymën e pushtimit të verbër dhe shkatërrues. “Porta” me kokëfortësi kërkon të heqë rrënjët europiane të Shqipërisë. Sidoqoftë, kjo perandori, për shkak të anakronizmit të saj, rikthehet në periudhën bashkëkohore. Komunizmi më pas paraqitet si avatar i despotizmit aziatik. Në veprat me një ton anti-utopik, Kadaré ilustron dhe dënon vullnetin e çoroditur në mjeshtëri absolute të një fuqie që është e ngjashme me të Keqin. Ashtu siç bëri Volteri para tij, Ismail Kadaré përdor alegori politike për të qenë në gjendje të kritikojë regjimin shqiptar dhe të shprehë lirshëm idetë e tij. Ai



tur “Frymëzime djaloshare”. Në 1963 botimi i romanit të tij të parë “Gjenerali i ushtrisë së vdekur” i sjell famën e duhur, në fillim në Shqipëri dhe pastaj jashtë shtetit në sajë të përkthimit të tij të përkryer, nga Isuf Vrioni. Një gjeneral italian që përshkon Shqipërinë në kërkim të italianëve të rënë gjatë Luftës së Dytë Botërore. Një libër satirë që e “zbuloi” Ismail Kadarenë, 25 vjet para se të kërkojë azil në Francë..Megjithë

të bëhej asokohe. Në 1990, Ismail Kadaré mori azil politik në Francë dhe sot ndan jetën e tij midis Parisit dhe Tiranës. Në vitin 1996, ai u zgjodh anëtar i huaj i asociuar i Akademisë së Shkencave Morale dhe Politike në Paris. Por, ky shkrimtar me famë botërore, autor i romaneve të shumtë (Daullet e shiut, Ura me tre harqe, Dimri i madh, Kronika e qytetit të gurtë, Piramida, “Tre këngë të kobshme për Kosovën”,

kështu transferon mosmarrëveshjen e tij drejt totalitarizmit përmes një historie që zhvillohet në një vend tjetër, në një kohë tjetër, në mënyrë që të mund ta shprehë këndvështrimin e tij pa rrezik, ose pothuajse, për t'u shqetësuar për sfidimin e regjimit. Romani i tij “Pallati i ëndrrave” zhvillohet në Turqi nën Perandorinë Osmane, por në realitet ai kritikon tiraninë shqiptare, dhe më saktë diktaturën staliniste, të

I DASHUR NIPI IM, KËSHILLA PËR TË MOS U BËRË IDIOT!

LETRA E FAMSHME E UMBERTO ECOS

Nuk do të doja që kjo letër e Krishtlind-jes të tingëllojë si e shkruar nga Deamici, dhe të të jepte këshilla dashurie për të singjashmit tanë, për vendin, për botën dhe gjëra si këto. As nuk do ia vije veshin dhe, kur të vinte çasti për t'i vënë në zbatim (ti i rritur dhe unë i ikur nga kjo botë), sistemi i vlerave do të ketë ndryshuar kaq shumë, sa që rekomandimet e mia ndoshta do të kenë dalë mode.

Kështu që dua të ndalem në një rekomandim, të cilin do të jesh në gjendje ta vësh në zbatim edhe tani, ndërkohë që lundron me iPad-in tënd. Nuk do të bëj as gabimin të të këshilloj që të mos e përdorësh, jo aq shumë se do të dukesh si një gjysh që ka mbetur me të vjetrën, por sepse e bëj edhe vetë. Më e shumta që mund të të rekomandoj, nëse rastësisht ndesh në qindra faqet pornografike që tregojnë në një mijë mënyra, marrëdhënien mes dy qenieve njerëzore, apo mes një qenieje njerëzore dhe një kafshe, përpiku që të mos besosh se seksi është ai që sheh aty, veç të tjerave tejet monoton, sepse bëhet fjalë për një aktrim, qëllimi i të cilit është të të mbajë mbyllur në shtëpi, e të mos dalësh të shohësh dhe takosh vajzat e vërteta. Po nisem nga parimi që ti je heteroseksual, përndryshe përshtati rekomandimet e mia me rastin tënd: por shiko vajzat, në shkollë apo atje ku shkon të luash, sepse janë më të mira ato të vërtetat, se sa ato televizivet, dhe një ditë do të të japin kënaqësi më të mëdha, se sa ato online. Besoji kujt ka më shumë përvojë se sa ti (dhe nëse unë do të kisha parë

vetëm seks në kompjuter, yt atë nuk do të kishte lindur, dhe ti kushedi ku do të ishe, madje nuk do të ishe fare).

Gjithsesi nuk doja të të flisja për këtë, por për një sëmundje që ka goditur brezin tënd, dhe atë të të rinjve më të mëdhenj se ti, që ndoshta janë në shkollë të lartë: humbja e kujtesës.

Është e vërtetë se, nëse të lind dëshira për të mësuar se kush ishte Karli i Madh apo ku ndodhet Kuala Lumpur, mjafton të shtypësh një taste në kompjuter dhe

Interneti ta thotë menjëherë. Bëje kur duhet, por pasi ta kesh bërë, përpiku të kujtosh atë që ke lexuar, që të mos jesh i detyruar ta kërkosh për së dyti, nëse do të të lindë nevoja, mbase për një detyrë shkollore.

Rreziku është që, duke qenë se mendon se kompjuteri yt mund të ta thotë në çdo moment, ti humbet shijen për ta ngulitur në kokë. Do të ishte pak a shumë njësoj sikur, pasi ke mësuar që për të shkruar nga Rruga Filan në rrugën Fistek, ka autobusë apo metro që të mundësojnë të lëvizësh pa u lodhur (gjë që është shumë komode dhe bëje kur e ke me nxitim), ti mendon se kështu nuk ke më nevojë të ecësh. Por nëse nuk ecën mjaftueshëm, ti bëhesh person "me aftësi ndryshe", siç thuhet sot për të treguar ata që ecin në karrocë me rrota. Dakord, e di që merresh me sport dhe di ta lëvizësh trupin, por le të kthehemi tek truri yt.

Kujtesa është një muskul njësoj si muskujt e këmbëve, po nuk e ushtrove dobësohet dhe ti bëhesh (nga pikëpamja mendore) me aftësi ndryshe, domethë-

miqtë, për të parë se kush e kujton më mirë. Nëse nuk të pëlqen poezia, bëje me formacionet e futbollistëve, por kujdes sepse nuk duhet të dish vetëm cilët janë futbollistët e Romës sot, por edhe ata të skuadrave të tjera, dhe ndoshta të skuadrave të së kaluarës (mendo që unë mbaj mend futbollistët e Torinos, skuadrës avioni i të cilës u rrëzua në Superga me të gjithë futbollistët në bord: Bacigalupo, Ballarin, Maroso etj.) Bëj gara kujtese, ndoshta me librat që ke lexuar (kush ishte në bordin e Hispaniolas në kërkim të ishullit të thesarit? Lord Trelauney, kapiteni Smollet, doktor Livesey, Long John Silver, Jim...) Shiko nëse miqtë e tu mbajnë mend se cilët ishin shërbëtorët e tre moskëtierëve dhe të D'Artagnanit (Grimaud, Bazin, Mousqueton e Planchet)... Dhe nëse nuk do të duash të lexosh "Tre moskëtierët" (dhe ti nuk di se çfarë do të humbasësh), bëje me një prej historive që ke lexuar.

Duket si një lojë (dhe është një lojë), por do të shohësh se si mendja jote do të popullohet me personazhe, histori,

vitesh duhet ta ndërrosh. Ndërsa truri yt sot mund të zgjasë deri nëntëdhjetë vite dhe në moshën nëntëdhjetë vjeç (nëse e ke ushtruar), do të kujtojë më shumë gjëra se sa kujton ti sot. Është falas.

Pastaj është kujtesa historike, ajo që nuk ka të bëjë me faktet e jetës tënde apo gjërat që ke lexuar, por ka të bëjë me ato që kanë ndodhur, para se të lindje ti.

Sot nëse shkon në kinema, duhet të hysh në një orë të caktuar kur fillon filmi, dhe sapo fillon, dikush të merr – si të thuash – për dore dhe të thotë se çfarë ndodh. Në kohën time mund të hyje në kinema në çdo moment, dua të them edhe në mes të filmit, mbërrihej teksa po ndodhnin disa gjëra dhe ne përpiqeshim të kuptonim se çfarë kishte ndodhur më herët (pastaj kur filmi rifillonte kuptonim nëse kishim hamendësuar si duhej – përveç faktit që, nëse filmi na kish pëlqyer, rrinim të shihnim edhe atë pjesë që e kishim parë tashmë). Ja pra, jeta është si një film i kohëve të mia. Ne vijmë në jetë kur shumë gjëra kanë ndodhur tashmë, prej qindra e mi-



në (le ta themi qartë) një idiot. Dhe veç kësaj, duke qenë se për të gjithë ekziston rreziku që kur të plakemi na vjen Alzheimeri, një prej mënyrave për të shmangur këtë incident të papëlqyeshëm, është të ushtrosh gjithmonë kujtesën.

Dhe vijmë tek dieta ime. Çdo mëngjes mëso ndonjë varg, një poezi të shkurtër, ose siç na bënin ne të mësonim "La Cavallina Storna" apo "Il sabato del villaggio". Dhe ndoshta bëj garë me

kujtime të gjithfarëlloj. Ndoshta ke pyetur veten, përse një herë e një kohë kompjuterat quheshin tru elektronikë: është sepse ata janë projektuar sipas modelit të trurit tënd (dhe tonit), por truri ynë ka më shumë lidhje se sa një kompjuter, është një lloj kompjuteri që ti e mban gjithmonë me vete dhe që rritet dhe fuqizohet duke e ushtruar, ndërkohë që kompjuteri që ti ke mbi tryezë, sa më shumë e përdor aq më shumë humbet shpejtësi, dhe pas disa

jëra vitesh, dhe është e rëndësishme të kujtosh atë që ka ndodhur para se të lindim; vlen për të kuptuar përse ndodhin shumë gjëra sot.

Sot shkolla (përveç shënimeve të tua personale) duhet të të mësojë që të memorizosh atë që ka ndodhur para se të lindje, por duket që nuk po e bën mirë, sepse shumë studime na thonë që të rinjtë e sotëm, edhe ata më të rriturit që janë në universitet tashmë, nëse kanë lindur rastësisht

◀ në vitin 1990 nuk e dinë (dhe ndoshta nuk duan ta dinë) se çfarë kishte ndodhur në 1980 (dhe nuk po flasim për atë që ka ndodhur pesëdhjetë vjet më parë). Statistikat na thonë se, nëse pyet dikë se kush ishte Aldo Moro, të përgjigjet që ishte kreu i Brigadave të Kuqe – ndërkohë që ai u vra prej Brigadave të Kuqe.

Nuk flasim për Brigadat e Kuqe, ato mbeten ende një mister për shumëkënd, e megjithatë ato ishin e tashmja vetëm 30 vjet më parë. Unë kam lindur në vitin 1932, dhjetë vjet pas ardhjes në pushtet të fashizmit, por dija se kush kish qenë kryeministër edhe në kohën e marshimit drejt Romës (çfarë është ky?). Ndoshta shkolla fashiste ma kishte mësuar për të më treguar se sa budalla dhe i lig ishte ai ministër, që fashistët e kishin zëvendë-

suar. Dakord, po të paktën e dija. Dhe pastaj, duke lënë mënjanë shkollën, një i ri i kohëve të sotme nuk di kush ishin aktoret e kinemasë të njëzetë viteve më parë, ndërsa unë dija se cila ishte Francesca Bertini, e cila luante në filma pa zë, 20 vite para se të lindja unë. Ndoshta sepse shfletoja revista të vjetra të grumbulluara në depon e shtëpisë sonë, por po të ftoj pikërisht të shfletosh edhe revista të vjetra, sepse është një mënyrë për të mësuar se çfarë ndodhte para se të lindje ti.

Po pse është kaq e rëndësishme të dish se çfarë ka ndodhur më parë? Sepse shumë herë, ajo që ka ndodhur më parë të shpjegon se pse disa gjëra ndodhin sot dhe, në çdo rast, ashtu si me formacionet e futbollistëve, është një mënyrë për të pasuruar kujtesën tonë.

Dakord, kjo nuk mund të bëhet vetëm me libra dhe revista, bëhet fare mirë edhe në Internet. I cili duhet përdorur jo vetëm për të bashkëbiseduar me miqtë, por edhe për të biseduar (fjala bie) me historinë e botës. Cilët ishin hititët? Kamisardët? Dhe si quheshin tre anijet e Kolombit? Kur u zhdukën dinosaurët? A mund të ketë pasur një timon Arka e Noes? Si quhej paraardhësi i demit? Kishte më shumë tigr 100 vjet më parë, apo sot? Çfarë ishte Perandoria e Malit? Dhe kush ishte personi që fliste për Perandorinë e të Keqes? Cili ka qenë Papa i dytë i historisë? Kur u shfaq Mickey Mouse?

Mund të vazhdoj në pafundësi, dhe do të ishin të gjitha aventura të bukura kërkimi. Dhe të gjitha për t'u kujtuar. Do të vijë dita kur do të jesh bërë plak

dhe do të ndihesh sikur të kesh jetuar një mijë jetë, sepse do të jetë sikur ke qenë i pranishëm në Betejën e Vaterlosë, sikur ke qenë aty kur vritej Jul Çezari, dhe ndoshta vetëm pak metra larg vendit ku Bertoldi i Zi, duke përzierë substancat në përpjekje për të prodhuar flori, zbuloi gabimisht barutin, dhe hodhi veten në erë (e mbase mirë iu bë). Miqtë e tu që nuk do ta kenë kultivuar kujtesën, do të kenë jetuar vetëm një jetë, të tyren, e cila do të ketë qenë e mbushur me melankoli dhe e varfër në emocione të mëdha.

Kultivoje kujtesën pra, dhe nesër lexo përmendësh "La Vispa Tesera" (poezi e Luigi Salierit).

Në shqip nga bota.al

◀ frymëzuar nga Enver Hodja. Historia nuk ka gjasa të merret në të vërtetë, nga njëra anë për shkak të dialogut të saj të shumtë dhe nga ana tjetër, për shkak të pamundësisë për të imagjinuar që një organizatë e tillë mund të kontrollojë ëndrrat dhe mënnrën tonë. të mendimit; por kjo tregon shumë mirë se si diktatura kërkon të marrë në zotërim mendjet e njerëzve dhe t'i ndikojë ata në cepin më të vogël të trurit të tyre. Brenda potencialit të tij krijues janë mitet dhe legjendat, e shkuara dhe e ardhmja, raportet e përkohshme dhe të përjetësive, dramet e kaluara dhe ato të tashmet, veset dhe virtetet shqiptare, kullat dhe pallatet moderne, qëndresa dhe humbja, zhdukja dhe ringjallja, të gjitha labirintet e jetës dhe të vdekjes. Duket sikur asgjë çka është shqiptare, nuk mund t'i shpëtojë syrit të shkrimtarit të madh. E gjithë vepra e Ismail Kadaresë që nga botimi i parë deri te i fundit ndrit nga mesazhi dhe shpresa për një Shqipëri të barazuar me shtetet më të qytetëruara të botës, sepse ashtu e meriton, ndihet të pohojë autori. U botuan 12 vëllime të veprave të plota të Kadaresë dhe ai konsiderohet qysh prej disa vitesh si një nga shkrimtarët më të mëdhenj të kohës sonë.

Ismail Kadareja ka bërë shumë edhe për Kosovën. Mjafton të përmendim letrën që i ka dërguar para disa vitesh ish Presidentit Francez lidhur me masakrat e serbomëdhenjve. Ai shkroi aq bukur parathënien e librit të Ibrahim Rugovës "Çështja e Kosovës" që u botua nga shtëpia botuese me prestigj "Fayard".

Pas rënies së komunizmit u botuan rreth 101 dokumenteve arkivore në vëllimet "Kadare i denoncuar" dhe "Kadare në 101 dokumente të "Pallatit të Ëndrrave" ku zbulohet përndjekja e shkrimtarit gjatë regjimit. Dosja e ndjekjes së Kadaresë nga organet e Sigurimit është më e vëllimshme e ndonjë personazhi publik në Shqipëri me 1280 faqe dhe katër vëllime.

Një ndër fushat më pak të lakuara

të veprimtarisë së Kadaresë janë përkthimet, të cilat i nisi më 1955, kur shqipëroi poemat Lisi, Fëminija, Në pyllin afër fronit, Katjusha, Pranvera, etj. të shkrimtarit rus M. Isakovski. Autorë të tjerë të shqipëruar prej tij janë: Eskili, Heminguej, Pushkin, Majakovski, Eminescu, Gogol, Esenin, Mihallkov, Shçipaçov, Mickieviç, Buske, Sendrar, Bodler, Andrade, Vijn, Kejler, Seferis, Kavafis, Elitis, Li Bo, Du Fu, Jan Czjun, etj

Ismail Kadare është laureat i shumë çmimeve letrare kombëtare dhe ndërkombëtare. Ai ka marrë Medaljen e artë të Lidhjes së Prizrenit, Kosovë. Në vitin 1992 u vlerësua në Francë me Prix Mondial Cino Del Duca. Ai mori në 1993 çmimin "Mesdheu-i huaj për romanin "Piramida"..Në 1997 mori në Itali çmimin "Bokaçio", në 1998 në Austri çmimin Herder Prize, në 2003 në Rumani çmimin Ovid Prize, në vitin 2005 fitoi çmimin «Man Booker International Prize» ku kishte qenë i nominuar bashkë me shkrimtarë të tjerë të mëdhenj, duke përfshirë nobelistë si Gunter Grass, Gabriel Garcia Marquez, Kenzaburo Oe etj. Kryetari i jurisë e arsyetoi vendimin për t'i dhënë çmimin Kadaresë me fjalët: «Ismail Kadare është një shkrimtar që hedh në hartë një kulturë të tërë: historinë e saj, dëshirën, folklorin, politikën, fatkeqësitë. Ai është një shkrimtar universal me traditë rrëfimi që shkon deri tek Homeri». Në vitin 2009 u nderua me çmimin spanjoll Princi i Asturias për Artet - çmimi më i rëndësishëm letrar në vendet spanjolle, dhe një nga çmimet letrare më prestigjioze në botë. Në vitin 2010 Ismail Kadare nderohet në Itali me çmimin Lerici Pea. "Dhënia e çmimit Lerici Pea 2010 autorit Kadare - shkruhet në motivimin e çmimit - nënkupton rolin e poezisë dhe letërsisë si instrument lirie, duke u bërë mbështetje për të gjithë njerëzit e botës, të cilëve iu mohohen liritë themelore". Në vitin 2015 mori çmimin Jeruzalem në Izrael, Ne 2016 në Francë « Komandant i Legjionit të Nderit",

në 2017 çmimin « Letërsia shqipe në Kosovë, në 2018 çmimin « Nonino » në Itali, në 2018 çmimin e karrierës akademike nga Akademia e Shkencave të Shqipërisë. Kadarë u nderua me çmimin Pak Kyongni për vitin 2019, më datë 26 tetor në Korenë e Jugut.

Enkas, në udhëtimet që kam patur fat të bëj në botë, si rezultat kryesisht i punës me organizatat ndërkombëtare, si në Nju Jork, Nju Xhersi, Paris, Vjenë, Kajro, Nairobi, Athinë, Limasol, Gjenevë, Rhodes, Romë, Bazel, Dubai, Singapur, Budapest, Florida, Nju Dehli, Palma de Majorjka etj., "gërmoj" në libraritë dhe bibliotekat e këtyre vendeve dhe shoh se librat e Ismail Kadaresë zenë një vend nderi në raftet e tyre. Shpesh pyes për aksh libër të Ismailit që nuk ndodhet aty dhe librashitësja thotë me dashamirësi se tanimë është blerë. Në Bibliotekën madhështore të Pallatit të Kombeve në Gjenevë, ku kam patur fatin të punoj në fillimet e viteve 90-95, kërkoheshin dhe lexoheshin me kënaqësi veprat e shkrimtarit Ismail Kadare. Dhe unë isha krenar që vija nga « vendi i Kadaresë ».

Nuk dua të bëj polemikë këtu në këtë shkrim të shkurtër me ndonjë bashkëkombas, apo edhe ndonjë "qoftëlarg", pasi nuk ja vlen të merresh me ta. Askush nuk mund ta përlyejë figurën madhore të Ismail Kadaresë dhe të letërsisë shqiptare. Për Ismail Kadarenë nuk mjaftojnë as disa qindra faqe të tëra për të shkruar për veprën e tij, për jetën e vullshme, për karakterin tepër njerëzor, maturinë, pjekurinë, inteligjencën dhe bonsensin e tij. Ato i gjen të shkruara në qindra e qindra botime kudo në botë. Kemi fat që një "Doctor honoris causa" është shqiptar, kemi fat që vepra e tij ndodhet kudo: në Kongresin amerikan, në Bibliotekën më të vjetër të botës, themeluar në shekullin e XII-të në Oksford të Anglisë, në Universitetin Jale (SHBA) etj.

Duam a s' duam ne, Ismail Kadare nuk i përket vetëm Kombit tonë, por botës letrare europiane dhe ndërkombëtare. Ai i përket mbarë njerëzimit.

Është pararendës i njohjes së letërsisë shqiptare në botë. "Gjenerali i ushtrisë së vdekur" dhe veprat e tjera të tij, hyjnë në fondin e artë të letërsisë botërore. Qysh i ri ishte ambicioz dhe energjik dhe me penën e tij shumë shpejt u imponua për të rezatuar letërsia shqiptare në Europë, megjithë censurën e diktaturës enveriane. Një akademik francez ka thënë për Ismailin tonë: "Toujours vous porterez l'Albanie et toujours l'Albanie vous portera" (Ju do të mbani gjithmonë Shqipërinë dhe Shqipëria do t'u mbajë). Profesori i njohur zviceran, Jean-Philippe Assal në një mesazh të fundit pas botimit të një shkrimi tim në "Panorama", rreth shkrimtarit Ismail Kadare dhe nderimit të tij me titullin "Oficer i Madh i Legjionit të Nderit", nga Presidenti i Francës, Macron, thekson se Kadare është një njeri unik dhe se i ka bërë përshtypje guximi i tij në komunizëm. "Unë sapo lexova artikullin tuaj të mrekullueshëm nga gazeta Panorama, shprehet ai dhe më ka bërë veçanërisht përshtypje admirimi juaj për Kadarenë dhe përkushtimin tuaj të plotë për këtë njeri unik. Guximi i tij në një situatë politike, e cila si duket bllokoi gjithë këtë shprehje të bukur të kulturës shqiptare për të cilën keni qenë një dëshmi madhore. Faleminderit juve, për urimet tuaja dhe këtë admirim për Kadarenë, që ju më bëtë për vitin 2020".

Të heq Kapelen miku im i mirë, modest, fisnik, por penë artë, Ismail dhe ty Helenë që ke qëndruar gjithmonë pranë tij në Shqipëri, Francë e gjetiu, ku ju kanë shpënë rrugët e jetës. Së bashku me nderimin e madh që i bëri presidenti i Francës së fundi, ne do bëjmë çmos dhe do ndikojmë që Njeriu ynë i Madh, Ismail Kadare të marrë faktikisht çmimin "Nobel" që e ka merituar prej kohësh. Më 28 janar 2020, festojmë me madhësi ditëlindjen e shkrimtarit tonë mbarëkombëtar, kollosit të letërsisë shqiptare dhe botërore.

ALFRED PAPUÇIU,
Gjenevë, më 28 janar 2020

TA DUAM DHE TA MBROJTMË GJUHËN TONË TË BUKUR

Prof. Gjovalin Shkurtaç*

Urimin tim për shqiptarët në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare do ta nis duke rikujtuar sa kam shprehur në librat e mi “Ta duam dhe ta mbrojmë gjuhën tonë të bukur” (SHBLU, 1998), “Urgjenca gjuhësore” (“Ada”, 2015 dhe “Naimi”, 2017) dhe në libra e shkrime të tjera sa herë ka qenë rasti për ta lëvdur e për t’u krenuar me vlerat përbashkuese dhe kombëtare të gjuhës shqipe për të gjithë shqiptarët kudo që ndodhen. Më pëlqen ta theksoj dhe ta vlerësoj interesimin dashamirës për gjuhën shqipe e të ardhshmen e saj si tipar përbashkues i kumtimit dhe i marrëveshjes midis të gjithë shqiptarëve në trojet e veta ballkanike, si dhe të atyre që janë në diasporat e hershme (në Greqi, Itali, Zarë, Mandricë, Ukrainë etj.) dhe të grupeve mërgimtare më të reja në metropolet e Evropës, të SHBA-së, Australisë etj.

Të gjithëve sa jemi shqiptarë, në Shqipëri, në Kosovë, në Maqedoninë e Veriut, në Mal të Zi etj. gjuha shqipe na shërben si mjet komunikimi, si mjeti kryesor i shprehjes dhe i të folurit, po edhe si tregues e simbol i përbashkësisë etnike dhe shpirtërore e kulturore, si hallkë e fortë shqiptarie. Kjo përbashkësi është kënduar e lëvdur në vjershat e poetëve më të shquar të kombit tonë, të cilëve unë, në gati të gjitha shkrimet e intervistat e mia, u jam referuar dhe i kam përmendur me nderim e duke i çmuar si peng të çiltër qytetar e kombëtar. Kam cituar Naim Frashërin, bilbilin e gjuhës sonë, i cili na ngazëllen edhe sot me thirrjen e tij përdëllimtare: “Shqip të flisni përherë, fjesht e të papërzierë”, si dhe Fishtën, i cili me mlllef e forcë të madhe, shprehet kundër fjalëve të huaja të panevojshme: “Dhe atij ju thaftë, po goja, që në gjuhë të huaj kur nuk asht nevoja flet e të vetën e len mbas dore!” Kam cituar sidomos Mjedën që thotë: “Kjoftë mallkue kush qet ngatërrime, ndër këta vllazën shoq me shoq, kush e ndan me fjalë e shkrime çka natyra vetë përpoq!” Prandaj, kërkesa për ta dashur, për ta njohur, për ta nxënë me baza të shëndosha gjuhën shqipe ka qenë dhe duhet të mbetet edhe më tej kërkesë me rëndësi të dorës së parë për shkollat shqipe, për administratën shtetërore e publike, për të gjitha botimet me karakter zyrtar e publik.

Së pari e kryekreje, sikundër e kanë shprehur edhe gjuhëtarë e studiues të tjerë të autoritetshëm, theksoj se krahas veprimtarisë gjuhëdashëse, që e ka pasur dhe e ka shprehur gjithmonë populli shqiptar, mbetet me rëndësi edhe veprimtaria gjuhëmbrojtëse e organizuar, prandaj në Ditën Ndërkombëtare të Gjuhës Amtare rikujtojmë kërkesën për domosdoshmërinë që Shteti dhe institucionet zyrtare e publike, që varen ose që lejohen prej tij, të zbatojnë politika mbrojtëse për gjuhën

shqipe. Natyrisht edhe përkujdesje të veçantë për shkencën e gjuhësisë dhe veprimtarinë shkencore të organizuar në universitetet shqiptare dhe nga institutet shkencore dhe komisionet për mbrojtjen e gjuhës shqipe të Akademisë Albanologjike, të Akademisë së Shkencave dhe të Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe.

Ndaj gabimeve e shkeljeve të pafalshme e të përditshme të rregullave të shqipes së shkruar e të gramatikës së gjuhës sonë, po tregohemi të pandjeshëm e, madje, neglizhues. Me ngut e me përgjegjësinë e duhur kërkohet të pastrohen e të rishikohen nga ana gjuhësore reklamat e televizioneve dhe titujt e titullimet e rubrikave, shumica e të cilave janë padrejtësisht e pa asnjë motivim bindës vetëm në gjuhë të huaja. Duhet të ndjekim shembullin e kombeve e vendeve



të mëdha, si Franca, Anglia, Italia etj. që tregojnë shumë kujdes për ruajtjen dhe mbrojtjen e gjuhëve të veta amtare. Puna është ta përmirësojmë cilësinë e botimeve dhe të publikimeve zyrtare. Sekretaret dhe punonjësit e administratës shtetërore dhe të institucioneve të tjera publike, të mos merren me facebook-un, por të mësojnë si bëhet korrektimi me programin e drejtshkrimit të shqipes, që është realizuar nga një grup studiuesish të IA të Prishtinës dhe të QSA-së. Mbi të gjitha të shtohet kujdesi për pastrimin e shqipes nga barbarizmat dhe “kallëpet” e huaja të panevojshme. Me doemos duhet të vendoset autoriteti i gjuhës së shkruar shqipe dhe të gjitha botimet zyrtare të kalojnë më parë në redaktimin dhe korrektimin në përputhje me rregullat e drejtshkrimit dhe normat gramatikore.

Për këtë, edhe kohëve të fundit, kam shkruar te gazeta “Dita” si dhe jam shprehur në intervistën të “Provokacija” e Mustafa Nanos, si dhe në kanale të tjera. Kam shkruar sidomos në librin tim “Urgjenca gjuhësore”, të cilin do të dëshiroja ta lexonin, së paku disa nga ata që janë kundër mbrojtjes së organizuar të gjuhës shqipe dhe, për fat të keq, janë vetë ata që shkruajnë me gabime trashanike e me shkelje të normës drejtshkrimore deri në titujt e librave “shkencorë”.

Koha jonë, me mundësitë shumë të mëdha teknike që zotërojmë, kërkon që kujdesi për drejtshkrimin dhe kulturën shkrimore të rrite e të jenë në një shkallë më të mirë. Mundësitë janë, shkollimi dhe diplomimi i masave të gjera të punonjësve e zyrtarëve është i lartë, por, për fat të keq, kujdesi dhe përkushtimi për shqipen e shkruar e të folur në mjediset e për funksione zyrtare e publike lë shumë për të dëshiruar. Këtë e kanë theksuar edhe shumë nga dashamirët e shqipes, si dhe shkrimtarë e mendimtarë të shquar, sidomos i ndjeri Arbër Xhaferi, akademikët Ismail Kadareja e Rexhep Qosja dhe shumë të tjerë. Që nga Amerika, gazetari dhe shkrimtari i njohur Skifter Këlliçi, i shqetësuar për gabimet e pafalshme në botimet zyrtare e në shtypin e shkruar, me shqetësim të ligjshëm kërkon të merren masa mbrojtëse për shqipen e shkruar

zyrtar e në të gjitha botimet me karakter zyrtar e publik. Në këtë kuadër, kohëve të fundit, kemi shprehur mbështetjen e plotë për punën e kujdesshme për mbrojtjen e shqipes në Republikën e Maqedonisë së Veriut, ku është krijuar dhe ka filluar punën Inspektorati Gjuhësor, si organizëm që ka për detyrë të vrojtojë e të realizojë zbatimin e shqipes letrare në botimet zyrtare e në administratën publike. Shqiptarët e Maqedonisë së Veriut, ndonëse janë pakicë gjuhësore e etnike, po kërkojnë e po punojnë me ngulm për mbrojtjen e shqipes zyrtarisht. Ne duhet patjetër të krijojmë, së paku në Akademi, një komision a grup pune pikërisht për mbrojtjen e gjuhës, duke mos lejuar gjendjen e pakujdesisë dhe gabimeve trashanike që po bëhen në botimin e librave dhe në gazetarinë e shkruar e të folur. Në jetësimin dhe krijimin e një bërthame studimore e kërkimore për mbrojtjen e shqipes duhet të punohet me shumë kujdes e duke siguruar patjetër edhe bashkërendimin me Këshillin Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe, por jo të mbetet vetëm sa ka bërë e sa do të bëjë Këshilli. Këshilli, qysh më 2004 kur u krijua, ka pasur karakter ndërkademiq, por duhet ta bëjmë patjetër një Këshill Kombëtar e të ngjashëm me Këshillin e Mbrojtjes së Frëngjishtes e të Frankonisë, i cili e ka qendrën në Francë, por që mbron frëngjishten në mbarë vendet dhe shtetet e tjera jashtë saj, ku flitet e shkruhet frëngjishtja. Edhe ne, me sa të jetë e mundshme, duke shfrytëzuar edhe hapësirat tashmë më të përshtatshme për shkëmbime e bashkëpunime me akademitë dhe universitetet në krejt hapësirat shqiptare në Ballkan e në diasporë, duhet ta ritheksojmë synimin mbrojtës të Këshillit Ndërkademiq të Gjuhës Shqipe.

Ndërkaq, me punën dhe shtjellimet e grupit të punës në Akademinë tonë, patjetër, ne duhet të japim shembullin e një përkujdesjeje për gjuhën shqipe, ashtu si po bëhet në Maqedoninë e Veriut nga Inspektorati Gjuhësor për mbrojtjen dhe zbatimin e gjuhës shqipe në të gjithë praktikën shkrimore e botuese. Ndaj gabimeve e shkeljeve të pafalshme e të përditshme të rregullave të shqipes së shkruar e të gramatikës së gjuhës sonë, po tregohemi të pandjeshëm e, madje, neglizhues. Me ngut e me përgjegjësinë e duhur kërkohet të pastrohen e të rishikohen nga ana gjuhësore reklamat e televizioneve dhe titujt e titullimet e rubrikave, shumica e të cilave janë padrejtësisht e pa asnjë motivim bindës vetëm në gjuhë të huaja.

Po ashtu, është e turpshme dhe e pafalshme që në gazetarinë e shkruar dhe në gati të gjitha emisionet e folura bëhen gabime trashanike, shtrembërime të emrave të krahinave e të qendrave qytetare, si p.sh. Betonolja e Shkodrës, në vend të Pedonalja, po aq më tepër kur edhe mund të thuhet shqip Këmbësorja.

Kam shkruar e folur me

DHUNA NDAJ GRAVE, PLAGË E HAPUR PËR SHOQËRINË

Çdo mëngjes, po dëgjojmë dhe po shohim, në gazeta, televizione, e mjete të tjera të informimit lajme nga më të ndryshmet nga kronika e zezë. Vrasje, aksidente, vjedhje, dhunime, shtrëngime për dhënie pasurie, e shumë ngjarje të tjera te rënda për shoqërinë tonë. Ato shfaqen në rrugë, institucione, familje, vende pune, biznese e të tjera.

Tranzicioni i stërgjatur, mos funksionimi, i ligjeve dhe institucioneve, mos evidentimi, parandalimi dhe zbatimi i ligjit me drejtësi në mënyrë të barabartë për çdo individ, ka bërë që krimi të marrë përmasa të frikshme në shumë raste, e në veçanti në zonat urbane dhe qytetet e mëdha të vendit tonë.

Është e dhimbshme dhe shumë shqetësuese dhuna në familje, e në veçanti ndaj fëmijëve e femrës. Ndryshimet e sistemit, lëvizjet demografike, emigracioni, niveli

i ulët ekonomik dhe kulturor, divorcet e tjera, janë faktor bazë, të problemeve e konflikteve familjare, të cilat shpesh po përfundojnë në vrasje, plagosje, dhunë fizike e psikologjike.

Familja është bazë e shoqërisë, qeliza që mban, ushqen dhe ndihmon, në zhvillimin e saj në bazë të kushteve dhe të rrethanave të kohës. Femra është nënë, është motër, bashkëshorte, gjyshe, mbesë, është faktori kryesor, për krijimin e zhvillimin e jetës në familje.

Ndjeshmëria, dashuria, përkushtimi, përballja me vështirësitë e jetës të femrave është hasur shpesh në mosmirënjohje të burrave, ose të meshkujve, të papërgjegjshëm, bajraktarë, e të dhunshëm në familje e më gjërë, duke shkaktuar trauma në jetën, personalitetin, në misionin e fëmijëve në familje, në shoqëri, në punë, në karriere e në shumë aspekte

të jetës.

Një shoqëri nuk mund të integrohet, pa qenë e integruar femra. Roli i saj në familje, rritja e pjesëmarrjes në strukturat drejtuese e përfaqësuese, pavarësia ekonomike, ngritja e nivelit arsimor e profesional, e të drejtës për vetëvendosje për vullnetin dhe dëshirat e saj, për jetën dhe të ardhmen.

Janë ngritur dhe funksionojnë shumë shoqata, jepen shumë e misione të veçanta televizive, shkruhen nëpër gazeta e revista, për mbrojtjen e jetës, të figurës e të personalitetit, të grave dhe të vajzave, e në veçanti, kur ngjarjet ndodhin, e viktimat janë pre e mos funksionimit sa e si duhet të punës, të keq koordinimit të këtyre hallkave shoqërore e shtetërore, që çojnë në dhunë e vrasje.

Edhe pse është ndryshuar legjislativi disa herë dhe rrit masa e dënimit të dhu-

shqetësim për tri nga drejtimet më të shqipes së sotme në gazetarinë shqiptare dhe në botimet zyrtare. Së pari, se krahas vullnit për të mësuar sa më shpejt e sa më mirë gjuhët e huaja, sidomos anglishten dhe italishten, kohëve të fundit edhe gjermanishten, si gjuhë pune e punësimi në vende të ndryshme jashtë Shqipërisë, ka shpërthyer në mënyrë të shfrenuar pakujdesia, ndonjëherë, edhe shpërfillja e gjuhës shqipe letrare. Ka pasur diskutime e "qarje" prej krokodili për gjoja zgjidhjen e pamirë të variantit letrar mbi bazën e toskërishtes, duke penguar kështu rrjedhën e mbarë të zbatimit të drejtshkrimit të njësuar dhe, madje, edhe duke rikthyer shumë fjalë të huaja të panevojshme, të cilat vite më parë ishin zëvendësuar me sukses me fjalët shqipe përkatëse ekzistuese ose të krijuara me brumin e shqipes.

Ka ndodhur dhe po vijon një vërshim i përshtuar dhe i pafrenueshëm i fjalëve të huaja të panevojshme, shtim i termave të huaja në vend të termave shqip që përdoren normalisht dhe nuk ka pse të mënjanohen. Kjo, qysh nga Kuvendi i Shqipërisë, të cilin, vetë ata që e përbëjnë (deputetët dhe drejtuesit e tij) në mbi 90 % të rasteve e quajnë "Parlament" dhe jo shqip Kuvend, siç e ka emërtesën zyrtare. Së këndejmi edhe kryeparlamentar (në vend të kryetar i Kuvendit). Kanë hyrë e nuk pushojnë së hyri edhe jo pak mënyra të të thëni apo ndërtime sintaksore të papranueshme për shqipen, thjesht si ndikim nga gjuhët e huaja.

Politikanët dhe shtetarët janë ata që japin më së shumti shembullin e keq në përdorimin e fjalëve të huaja të panevojshme. Ata janë të parët që sjellin terma të huaj e të pakuptueshëm nga masat, si dividenti, inceneratori, rankimi i universiteteve, staf, bord, draft, prioritet, prioritar-e, guadria di financia, ekzil, moment, fluks, fokus, frustracion, risk e riskoj, premioj, lider, lidrship, investigoj, interfeoj, interferim, konsensus, konsensual-e etj. etj. Fill pas tyre vijnë

gazetarët dhe analistët, të cilët, nganjëherë si pasojë e përsëritjes së papeshuar e të pamenduar të asaj që dëgjojnë a regjistrojnë nga bisedat apo shkrimet e politikanëve e shtetarëve, po më shumë edhe nga pakujdesia e qëndrimi i tyre i pandërgjegjshëm, nga nguti e mosnjohja e shqipes dhe e fjalorit të saj, lëshojnë përbindshërira siç është, ndër të tjera, i famshmi "komisioni bipartizan", në vend të "dypalësh, i dy partive, dy partiak a prej dy partish"; vrasje e dyfishtë, e trefishtë, e katërfishtë etj. (në vend që të thuhet shqip: vrasja e dy vetave apo e tre vetave etj.). Kështu, nga padija e pakujdesia e shkruarve dhe folësve (qofshin politikanë apo gazetarë) që e lëshojnë për herë të parë nga goja, fjalët apo termat e huaj bëhen si orteku që nuk e ndalon dot. Për të ditur kuptimin e tyre, siç shihet, do të duhej me doemos një fjalor anglisht-shqip dhe nja disa fjalorë të tjerë dygjuhësh italisht-shqip. frëngjisht-shqip etj. Huazimi i fjalëve të tilla, sidomos i anglicizmave (qoftë të marra nga anglishtja e BE-së, qoftë nga anglo-amerikanishtja) vijnë në shqipen në kuadrin e një dygjuhësie të çalë, d.m.th. nëpërmjet nëpunësve që jo vetëm nuk e dinë mirë anglishten, por edhe që nuk kanë as ndershmërinë, as përgjegjësinë më të vogël që, së paku, para se të flasin e të shkruajnë shqip, ato që i kanë lexuar a dëgjuar në anglisht, t'i shohin se si përkthehen në fjalorët anglisht-shqip, të cilët tashti, fatmirësisht nuk na mungojnë. Kur dëgjon disa prej emisioneve radio-televizive publike e private të duket sikur jemi të pushtuar nga ndonjë ushtri anglishtfolëse dhe, që qysh nga pashtrima "uau" e deri te intonacionet e shtrembërimet e imitimet e huaja, shqipja nuk ngjan më si gjuha jonë, por si një përzierje a "hibride" e tipit të "franglais" (frënglishtes), kundër të cilës me aq zell e atdhetari luftojnë prej vitesh francezët. Edhe neve na kërcënon sot rreziku i një "shqipanglitalishteje", prandaj, në qoftë se nuk duam që një shqipe e përcudnuar të përcudnojë edhe mendjen e shqip-

tarëve, duhet që shteti dhe krejt shoqëria e qytetëruar shqiptare të shkonden nga letargjia dhe të dalin nga mjegullnaja e kësaj shqipanglitalishteje që rrezikon të na kaplojë.

Ra tërmeti në nëntor dhe, sa herë flitej për atë fatkeqësi, u stërpërdor folja panikosem, a thua se shqipja nuk ka fjalë të vetat për të shprehur frikësimin, drithërimën, drojtjen etj. Por, puna nuk mbaron vetëm me qëndrimin ndaj fjalëve të huaja të panevojshme. Kanë marrë përmasa shumë të mëdha format e gabuara gramatikore në vend të formave të zakonshme e të mira të shqipes. Kaq dendur po këndoret forma e gabuar e tipit i tha atyre (në vend të u tha atyre), sa që shumëkush mund të mendojë se ajo është forma e drejtë. Më duket e rëndë të kujtojmë se në të gjitha librat e shkollës, që nga klasa e parë deri në mbarim të shkollës së mesme, shqiptarët kanë pasur e kanë këshillimin e formave të drejta (normative), si: u tha atyre, t'u kthehem lajmeve nga vendi; t'u tregojmë të vërtetën etj. (në vend të formave të gabuara, si i tha atyre, t'i kthehem lajmeve etj.). Prandaj, është tregues analfabetizmi kur gazetari shkruan ose thotë me gojë: "X duhet t'i kërkoj falje maturantëve. (Në vend të formës së drejtë: t'u kërkojë falje maturantëve.)

Për turp e dem të madh shkruhen në formë të gabuar dhe pa përfillur rregullat e pikësimin, që nga më e vogla, apostrofi. Na vjen për të qeshur (po më fort për të qarë), kur shohim se shkruhen pa apostrof format mi, ti, tu (mi dha, ti thuash, tu sjellësh), që edhe nxënësit e klasës së dytë të shkollës fillore e dinë se shkruhen me apostrof (m'i, t'i, t'u) dhe, çuditërisht, janë të shumtë ata që i shkruajnë me apostrof format ma, ta (!) Kjo na kujton shprehjen urtake "Bir, Selman i nënës, çfarë të të qaj më parë!"

Gabime të tilla, sa trashanike aq edhe qesharake, na kujton sa thoshte Faik Konica për analfabetët me diplomë: "Po sot shoh një turmë të errët prej analfabetësh me diplomë në xhep, që po i vërsulen shq-

nës në familje, faktet dhe statistikat flasin për shifra jo në rënie, pavarësisht nga pauzat në kohë mes ngjarjesh. Më të theksuara ato shfaqen, në zonat urbane, në rrethinat e qyteteve të mëdha, ku papunësia, varfëria dhe konfliktet në familje për motive të ndryshme janë më të shpeshta. Rritja e divorceve, marrja e përgjegjësisë për kujdestarinë e fëmijëve pas divorcit, përpjesëtimi i pasurisë, mos zbatimi i urdhrit të mbrojtjes, të dhënë nga gjykata për gratë, por po ka raste edhe për burrat, janë vatra të përhershme për konflikt.

Nuk mund të emancipohet një shoqëri, pa qenë femra e emancipuar me të drejta të barabarta me mashkullin në çdo aspekt të jetës. Shoqëria jonë ka detyrim primar, që respekti, e drejta e ligjshme për gratë dhe vajzat duhet të rritet, si faktor i rëndësishëm i integritetit, në shoqëritë e përpëruara, të kombeve të zhvilluara të bashkimit evropian.

Duke u uruar festën e 8 Marsit nënave e motrave shqiptare, mbesim me shpresë për balance dhe arritje më të mëdha në të ardhmen, në rritjen e rolit dhe të drejtave të tyre të rëndësishme në përparimin e shoqërisë tonë.

Zef Bari

ipes dhe duan t' i vënë thikën në kurriz, që ta gdhendin pas formës që u pëlqen atyre; se të gjerët kujtojnë që gjuha është një copë dru pa shpirt. Nuk dinë që është jo vetëm e gjallë, po dhe shumë e hollë, aq sa, po i shtrembërova pakëz një nyjë a një dell, trupi i tërë i tronditet, vuan dhe humb forcën bashkë me bukurinë".

E përmenda këtë vlerësim të Konicës së madh sepse dua të ndalem më shumë në punën dhe peshën e gazetarëve e përgjithësisht të mediave të sotme në përdorimin e gjuhës. Pësimet e pamëruara të gjuhës shqipe në kohën tonë janë të tilla që, çdo gjuhëtari e dashamirësi të shqipes që ka ndonjë pikë gjak shqiptari, nuk mund të mos i vijë keq e të mos shprehë zemërim. Sidoqoftë, më tepër se çdo vërejtje a kritikë, në punën e gazetarëve dhe përgjithësisht të punonjësve të medias, të letrave e të skenës shqiptare, duhet të vlerësojmë rolin e tyre si përçues të fjalës shqipe, si përhapës të normave gjuhësore të sotme e të bukurisë së gjuhës letrare kombëtare që me aq mundim e kemi prurë deri në këtë shkallë. Kam shkruar e thënë disa herë se gazetarët janë edhe mësues të shqipes për masën e gjerë të lexuesve. Ky nuk është një vlerësim që e bëj vetëm unë. Bashkë me aktorët e skenës e të ekranit dhe shkrimtarët, armata jonë e gazetarëve shqiptarë ka në dorë më shumë se çdo mësues e pedagog (më tepër se universitetet a institutet e gjuhësisë) t' i prijë për së mbari kulturës së gjuhës shqipe.

Le të jetë ky vlerësim edhe si kërkesë e urim i çiltër që të gjithë sa jemi, sipas detyrave e punëve që kryejmë, të tregojmë dashuri, po edhe kujdes e mbrojtje të përkushtuar për gjuhën shqipe, për gjuhën tonë amtare, që është, si thoshte Naimi "sa e ëmbël, sa e vlerë".

*Akademik Emeritus,
botuar në gazetën DITA,
21 shkurt 2020

ANKTHI I GJENERALIZUAR

(TURBULLIMET ANKSIOZË TË PËRGJITHËSUARA)

Ankthi i gjeneralizuar është një afekcion psikiatrik nga ana statistikore takohet me shpesh te grat dhe tek adultet e ri. Karakterizohet me shfaqje fizike, me kriza (paraksostike) në sfondin e një ankthi të përhershëm. Aspekti psikologjik ose ekuivalentet somatik (trupore) janë të shumta dhe të ndryshme si ankth dhe shqetësim i tepërt ku përmbahen gjendje e ngjarje të ndryshme. Ai karakterizohet pikërisht me prani konstante shqetësimesh që është e vështirë të kontrollohen. Ankthi i përgjithësuar përfshin simptoma të ndryshme si **Manifestimi psikologjik**-Ankth, shqetësim i tepërt dhe i papritur (i cili vjen në befasi) në mënyre të përgjithësuar dhe të përditshme për një periudhë më pak se 6 muaj. Sidomos në aktivitete e fëmijëve shkollorë. Vështirësi për ta kontrolluar ketë ankth dhe harruar shqetësimet. Ankthi dhe shqetësimet shoqërohen më të paktën 3- nga 9 simptomat e mëposhtëm:

1. Agjitim ose ndjenje fluturimi . ndjenje paaftësie
2. Lodhje
3. Vështirësi përqendrimi ose humbje kujtese
4. Irritim / ngacmueshmëri ,
 - Tension muskolor, i tkurrur dhe në veçanti vështirësi në zënie gjumi dhe zgjime natën
 - mendime të errëta dhe të mërzitshme të cilat shfaqen në mënyre të pavetëdijshme gjate kohës së gjumit.
5. Spazma dhe dhimbje në stomak që here here janë shumë të ashpëra dhe rekuente (përsëritëse)
6. Turbullime të ushqyerjes, pikërisht dhimbja e stomakut dhe spazma që radhë mund të çojnë në dehidratim.

Pamundësi, rraskapitje dhe ethe janë turbullime të zgjatuar duke len fushe të lire për sëmundje të tilla si rrufa, gripi etj. Për të vene diagnozën duhet të sigurohemi se ky ankth nuk lidhet me turbullimet e tjera anksiozë dhe nëse ai shkakton një vuajtje domethënëse ose një alterim të funksionit social ose shkollor për fëmijët.

Ankthi i gjeneralizuar ose e quajtur ndryshe neuroza anksiozë ka dy aspekte, njeri i sfondit kronik shfaqja anksiove, dhe tjetra më e mprehtë dhe brutale me kriza ankthi që takohet në gjendje ku personat futen në një ose shume skena negative. dhe behet vigjilent, shume i prekshëm dhe i ndjeshëm ndaj agjenteve stresues të ambientit

- Shfaqja somatike (trupore)

Ekuivalentet trupor janë shume më të zakonshëm sesa krizat e ankthit për të cilat flitet vërtete. Mund të takojmë një numër formash, ku në ketë liste futen shfaqje nga ana e zemrës dhe enëve të gjakut, e çrregullimeve të frymëmarrjes si p.sh rritja e tensionit të gjakut, rritja e tensionit të syrit (Glaukoma akute)

me skuqje të syve me kriza rrahje zemre (takikardie) me gjendje këputje, vilanie (të fiket) dhe mbi në zonën e zemrës, me psedudo angor (para infarkte)

Nga ana e frymëmarrjes, vështirësia respiratorë ka formën e astmës, ngulçimit, sindrom hiper-ventilimit, me kriza tetanike, konvulsione, kriza kolle nervore.

do i kurseni organizmit tuaj stresin, ankthin pa u varur nga rrethanat apo lajmet.

Bini në qetësi.

Shumë ndërmarrje në botë kanë rregulluar menaxhimin e vendeve të qeta ku punonjësit të kalojnë disa momente të qeta larg zhurmave të kompjuterëve,

muzike.

Bëni masazh. Kur jeni në tension muskujt janë të sforcuar dhe të tkurrur, gjë e cila çon në pakësimin e gjakut dhe uljen e oksigjenit, bëni masazh, i cili mund të behet nga vete personi, automasazh me një top tenisi aty ku ndihen tendosje, si në qafe, shpatulla e kavalje. Mund të për-



Në aparatën tretës ka spazme në faring, rendim, rrahje stomaku, spazme zorrësh, kolit spastik, shtrëngime në zorrën e trashë, vështirësi në jashtëqitje, etje, uri me kriza.

Po ashtu ka dhimbje beli, në zonën e fshikëzës urinare, mund të ketë vështirësi në urinim, dhe turbullime seksuale etj.

Duke u nisur nga shenja të lartpërmendura kuptohet që nuk është e lehtë të mposhtet ankthi, por mund të jeni të vlefshme disa këshilla, që nga larg i sëmuri anksioz jep përshtypjen e një vuajtje me dhimbje koke, sy të skuqur, prerje barku, rrahje zemere, i mërzitur, me ankth të vazhdueshëm, humor të zymte, lëviz si i vetmuar etj.

Ja disa këshilla:

Përqendrohuni në punën tuaj

Mos bëni shumë gjëra njëherazi, fokusohuni një gjë dhe mos u merrni me punë tjera pa funduar të parën. Kështu çdo punë do të hajë më pak kohë, dhe padyshim do të ndiheni më të çlodhur dhe më të kënaqur në punë që bëni.

Bëni pushim për të mos marrë asnjë lajm. Një ditë në javë bojkotoni lajmet, mos ndiqni lajmet, lexoni gazetatat. Nëse ka ndonjë gjë madhore ju duhet të jeni më mirë n.q.s. nuk e dini. Gjate kësaj dite ju

printerëve, telefonave, makinave, nuançave të tjera zanore.

Merrni pushime kur nuk ndiheni mirë dhe relaksoni veten. Ditët e pushimit janë të nevojshme për të mbetur aktiv dhe menaxhoni zemrën tuaj, planifikoni mirë pushimet që të ktheheni mirë, në forme të plote.

Mund të adaptoni një kafshë shoqëruese sidomos femrat. Një studim i realizuar në Kinë, Australi e Gjermani, ka vlerësuar se personat që shoqërohen me kafshë shtëpiake shkojnë shumë radhë të mjeku për vizitë, kanë më pak probleme me gjumin, marrin më pak ilaçe për zemrën.

Përdorni objekte kundër stresit në jetën e përditshme, për të qetësuar mendjen, për të ulur lodhjen, si objekte prej gome me imazhe të ndryshme ose drite me ngjyra ose lëshojnë era relaksuese.

Merrni fryme thelle kur ndjeni ankth, stres. Proveni të merrni fryme thelle ngadalë dhe thelle 5-6 here me pauza te shkurtra.

Dëgjoni muzike, është vërtetuar se kur behen operacione të vogla me anestezi lokale, me mpirje, personat që dëgjin muzikën e preferuar, gjate ndërhyrjes ishin më pak anksioz dhe kishin më pak lëkundje të tensionit dhe të rritmi të zemrës krahasuar me ato që nuk dëgjin

dorni dhe joga për rritjen e mirëqenies mendore dhe fizike. Mund të përdoret schiatssu masash japonez me presion bulat e gishtërinjve në pika të ndryshme në fytyrë, kokë, gjymtyrë, gjë e cila pakëson stresin dhe ankthin dhe ule dhimbjet.

Duhet të shpërtheni në vaj (lot) kur e ndjeni duke mos i mbajtur lotët sepse largojnë lendet e dëmshme të krijuar në organizëm si rrjedhojë e energjive negative të krijuara

Hani darke herët, të paktën 2- ore para gjumit, merrni qumësht, djathë e kos, të cilat kane triptofan, reçel qershie që ka melatonin, e cila ndihmon gjumin. Po ashtu dhe çokollata ka magnez, i cili është relaksues i forte dhe anti stresues. Proveni të flini mjaftueshëm, deri në 8 ore. Për ketë duhet të keni një dhomë të qete, të erret, pa zhurma, dhe nëse nuk ju zë gjumi përdorni ilaçe bimore, si bare blete, kamomil, valeriana dhe deri te gjumë sjellësit e fundit zolpidem, triazolam, që nuk janë benzo-diazepina dhe nuk krijojnë varësi, por duhet të merren nën këshillën e mjekut. Mos u vet-mjekohuni, por këshillohuni me mjekun mundësisht me nuro-psikater.

Përgatiti,
Dr. Med. NDUE NIKAJ, Shkodër

KORONAVIRUSI?: MUND TË JETONI DUKE NDJEKUR FRIKËN OSE DUKE PASUR BESIM NË JETË!



Suela Ndoja

Psikologe
klinike/Psikoterapiste EMDR

Ndërsa koronavirusi përhapet, gjithnjë e më shumë njerëz po shqetësohen për atë që do të thotë në jetën e tyre. Është krejtësisht normale të ndjehesh në ankth për këtë krizë shëndetësore që është shfaqur aktualisht. Një shpërthim i ri i viruseve është më i frikshëm se një epidemie ekzistuese shëndetësore. Shumë media dhe burime të tjera informacioni në internet dhe media sociale e theksojnë problemin – dhe rreziqet shoqëruese të tij. Çfarë ndodh me ne? Çfarë duhet të bëjmë? A ka ndonjë gjë që mund të ndikojë në vendimet tona, sjelljet tona, dhe mund të përmbalidhet në një pyetje: me cilën ndjenjë e vendosim veten në jetë?

Nëse diapazoni i synimeve që ndikojnë në veprimet tona mund të jetë i pasur me konotacione të ndryshme, prapa gjithë kësaj ekziston një vendim themelor midis dy ndjenjave të kundërta që mund t'i ndiejmë drejt jetës, dhe është zgjedhja e ndjenjës mbizotëruese që do të kushtëzojë si t'i afrohem njerëzve që i njohim apo jo, përvojat që do të kemi, mundësitë që do të hapen në rrugën tonë; këto dy ndjenja janë **besim** dhe **frikë**.

Kur **besimi** mbizotëron tek ne, para së gjithash besimi tek vetja dhe aftësitë tona para të tjerëve, ne i japim vetes mundësinë që të hapemi drejt botës me gjithë problemet ekzistuese, të jemi empatik, të kemi përvoja të reja, të mësojmë aftësi të reja; ne i japim vetes mundësinë për të qënë me vetëdije në jetë rreth asaj çfarë është ndodhur në botë.

Ndërsa në këtë rast jemi ne që i përshtatemi jetës duke pranuar sfidat që na ofron dhe duke evoluuar falë mësimi që kërkohet prej nesh që të vazhdojmë në një rrjedhë normale, në rast se **frika** mbizotëron në jetën tonë, ne atëherë do të përqipemi ta anullojmë botën drejt vullnetit tonë, duke ushtruar kontroll të vazhdueshëm mbi çdo pjesë të realitetit që do të privonte jetën tonë nga ajo sasi e paparashikueshmërisë, për të cilën ne kemi nevojë për të zhvilluar

aftësi të reja, për të qënë pjesë e përvojave të papritura siç është edhe koronavirusi si një sëmundje infektive.

Për **Frikën** ajo ka një efekt të kundërt në jetën tonë në krahasim me besimin: në vend që të na shtyjë drejt zgjerimit dhe zbulimit, frika na mbyll gjithnjë e më shumë brenda nesh, na bën të ngurtë, emocionalisht të ftohtë, na bën të pasigurt dhe gjithnjë e më të dyshimtë në krahasim me aftësitë tona: na largon nga besimi dhe nuk është e dobishme të mbrohemi nga rreziqet siç mund të mendojmë, sepse pjesa më e madhe e frikës që kemi në jetën tonë janë rezultat i ideve dhe mendimeve që ne i ushqejmë vazhdimisht duke u bërë keq për të kaluarën, të tashmen apo edhe për të ardhmen. Frika është instiktive, nuk na lejon të arsyetojmë, dhe për këtë arsye nuk na lejon të ndryshojmë dhe të japim një kthesë pozitive në jetën tonë.

Nëse frika na pengon të arsyetojmë dhe duhet të shmangemi sa më shumë që të jetë e mundur, a do të thotë kjo se duhet të hedhim veten në botë me krahë të hapur dhe

zgjedhje pas zgjedhjeje. Sidoqoftë, mbani mend se në çdo moment mund të vendosim të ndryshojmë drejtimin. Për të mirën tonë. Si rrjedhojë është e këshillueshme që të ndjekim këshillat e ekspertëve botërorë në një rast shqetësues për ekzistencën tonë siç është koronavirusi, por jo vetëm:

Përqendrohuni në atë që ju forcon (jo atë që ju frikëson)

Truri ynë është dy herë më i ndjeshëm ndaj asaj që mund të shkojë keq (ose të humbet) se sa ato që mund të shkojnë siç duhet (ose të fitohen!) Si të tilla, imazhet e tmerrshme të pandemive (ose ngjarjeve të tjera në mënyrë të ngjashme kataklizmike) kanë një mënyrë për të kapur imagjinatën që një grip i zakonshëm thjesht nuk ka. Frika ka një mënyrë për të rrëmbyer të menduarit racional, duke na shtyrë që të terrorizohemi me imazhe tmerrë që, në të vërtetë, nuk janë shumë të mundshme, nëse jo plotësisht të padukshme. Sa më e shqetësuar klima, aq më e qëllimshme duhet të jesh për të rivendosur vëmendjen tuaj drejt rezultat-

filloni të përshkruani një situatë si gjuhë të pakuptueshme, atë do ta përjetojë trupi dhe mendja juaj. Kjo nuk ka të bëjë me mohimin e realiteteve të pakëndshme dhe minimizimin e rreziqeve legjitime. Thjesht do të thotë që nuk i bisedoni ato. Kur përdorni gjuhë që nënkupton se i besoni vetvetes për të përmbushur sfidat tuaja ndërsa ato lindin, jo vetëm që kurseni vetveten shumë stres, por kurseni edhe të tjerët duke mos e përhapur atë. Që na sjell në pikën tjetër ...

Shmangni frikësuesit (ose të paktën mos lejoni që frika e tyre të bëhet e juaja)

Frika furnizon frikë. Nëse vazhdimisht jeni duke biseduar me njerëz në ankth të zhytur në frikë dhe katastrofizim, do ta keni të vështirë të mos lejoni që ankthet e tyre të bëhen tuajat. Ndërsa është e rëndësishme të shmangni kullimin e energjisë negative në njerëz në kohën më të mirë, kur frika po mbizotëron, është edhe më kritike. Pra, ashtu si përpiqeni të minimizoni ekspozimin ndaj viruseve, gjithashtu duhet të minimizoni ekspozimin ndaj personave që nxisin stresin.

Edukoni veten (gjeni faktet përtej titujve)

Të gjithë jemi të lidhur me paragjykim të negativitetit. Kjo është arsyeja pse ne ndonjëherë duhet të bëjmë një "vetë-ndërhyrje" dhe të kërkojmë në mënyrë aktive informacione që ekuilibrojnë të gjithë negativitetin që po ushqehemi. Për shembull, ndërsa koronavirusi është shumë infektiv, jashtë Kinës ka një normë vdekshmërie prej 0.2% (krahasuar me SARS që ishte rreth 10%) çdo vit 60,000 njerëz vdesin nga gripi i zakonshëm dhe shumë pak njerëz jashtë provincës Wuhan që kanë kontraktuar koronavirus kanë vdekur përveç të moshuarve dhe ata me gjendje para-ekzistuese shëndetsore.

Vazhdoni me jetën tuaj (pasi inkurajoni të tjerët të fillojnë me të tyren)

Unë në këtë kohë po planifikoj një udhëtim për një workshop në Wien. Sigurisht që jam e ndërjegjeshme që udhëtimet mund të prishen ose planet të ndërrohen, por jam gjithashtu shumë e përkushtuar që të mos lejoj që frika ime se çfarë mund të shkojë keq, të më mbajë nga fillimi me punën dhe jetën time. Unë thjesht nuk dua të jap frikë më shumë fuqi sesa garanton. Unë dua jo më pak për ju. Për të marrë masa paraprake të arsyeshme dhe më pas vazhdoni me jetën tuaj.

Përmbledhtazi, në mbyllje

Besimi ynë është ai që na mban të paprekur dhe të fortë, të aftë për të menaxhuar vështirësitë që do të hasim dhe të cilat do të përballlemi me guxim duke pranuar të ndryshojmë, t'i përshtatemi jetës në rrethanat që na paraqiten dhe të evoluojmë.



gjithashtu të rrezikojmë jetën tonë? Natyrisht jo. Kur flasim për besim, ne flasim mbi të gjitha për vetëbesim dhe kjo është parakushti për të vepruar me respekt për veten dhe me vetëdije ndaj gjërave që ndodhin dhe që zbulohen çdo ditë e më shumë..

Të jetosh me **vetëbesim** do të thotë të jesh i aftë të zgjedhësh për të mirën vetjake, pa u ndier i detyruar t'i përgjigjesh një modeli të vendosur nga të tjerët ose nga shoqëria, do të thotë të njohësh aftësitë vetjake dhe të mos kesh frikë t'i përdorësh ato, do të thotë të mirëpresësh këshillat e dikujt dhe ta manifestojmë sepse është një mënyrë e të shprehurit që na korrespondon dhe na bën të ndjehemi të gjallë. Ne e kushtëzojmë këtë dhuratë, për më mirë ose për keq, me të gjitha ato zgjedhje të lëvizura nga një ndjenjë në vend të një tjetre, kështu që le të pyesim veten se cilat ndjenja mbizotëruese janë strehuar tek ne: besimi apo kontrolli? Dashuri apo frikë?

Për ta kuptuar atë duhet vetëm të vëzhgojmë nuancat e jetës që kemi rreth nesh dhe të jemi të sinqertë me veten, sepse jeta jonë është e përbërë nga ajo që bëjmë me të,

eve pozitive që dëshironi të krijoni sesa të shqetësoheni për gjithçka që nuk bëni.

Dyfishoni fuqinë e ritualeve dhe praktikave

Mbrojtja më e mirë kundër çdo virusi është një sistem i fortë imunitar. Dhe pak gjëra e kompromentojnë sistemin tonë imunitar më shumë sesa stresi. Kështu që, kur frika shfaqet e madhe dhe problemet shtohen, gjëja më e mirë për të bërë vetë është të investoni kohë në çfarëdo që ju ndihmon të shkatërroni, të ndjeheni më të fortë dhe të trajtoni më mirë sfidat tuaja. Ushtrimi. Hani mirë. Fleni gjumë Meditoni.. Dilni në natyrë. Përcaktoni orarin tuaj. Bëni më shumë nga çfarëdo aktiviteti më të fundit, rimbushni dhe rivendosni hapësirën tuaj hapësimore. Dhe nëse njerëzit përreth jush janë mbështetur mbi ju për mbështetje dhe siguri, atëherë keni më shumë arsye për të dhënë përparësi në praktikat që ju bazojnë.

Flisni me qetësi (dhe shmangni gjuhën melodramatike)

Fjalët tona krijojnë realitetin tonë. Nëse

PASOJAT E DROGËS NË TRURIN E ADOLESHENTËVE



Para dhjetëra vitesh është menduar, se truri i të rinjve, është ndryshej nga ai i të rriturve, mendim i cili, para pak vitesh, është vërtetuar shkencërisht dhe nuk është më vetëm mendim por, një e vërtetë. Shkencëtarët, para ca vitesh, mendonin se truri e përfundon rritjen e tij, kur fëmija mbush moshën dhjetë – dymbëdhjetë vjeç. Sot dihet diçka krejt tjetër. Pjesët e trurit, të posaçme për vetëkontroll, ndjenja, aftësinë e të gjykuarit dhe oragnizim, e përfundojnë zhvillimin e tyre të plotë vetëm në moshën 20 deri në 22 vjeç.

Duke u nisur nga ky përfundim shkencor, truri i të rinjve, në fazën e zhvillimit të tij, është shumë i rrezikuar. Ashtu si tek fëmijët e moshës, nga një deri në tetëmëdhjetë muaj, edhe tek truri i të rinjve ndodhë një mbiprodhim i masës gri të trurit.

Ndërkohë që fëmijët e vegjel nuk e kuptojnë dot se çfarë duhet të mësojnë dhe si duhet ta shfrytëzojnë këtë periudhë, për të regjistruar sa më shumë, të rinjtë kanë njëfarë kontrolli në këtë fazë.

Gjatë kësaj periudhe mbiproduese, në trurin e të rritur krijohen të gjitha qelizat e nevojshme, për lidhje dhe komunikim me botën e jashtme. Paralelisht me këtë, ndodhë edhe një fenomen tjetër, i cili mund të mendohet i dëmshëm. Të gjitha qelizat, të cilat nuk hyjnë në përdorim gjatë kësaj periudhe, që nuk aktivizohen por janë pasive, asgjeshen nga vetë truri. Ky asgjesis është i parikthyeshëm.

Nëse të rinjtë, e kalojnë kohën në divan, me telefonin e dorës, dukue lozur, apo para televizorit, qelizat vazhdojnë vdekshmërinë e tyre të lartë. Nëse truri, në moshën 20-22 vjeç, është vetëshplarë nga qelizat e “tepërta”, nuk i kërkon më ato dhe për gjithë jetën nuk ndryshon gjë. Njeriu mbetet në një masë të konsiderueshme i paaftë, për punë dhe komunikim social.

Është fare e lehtë për mësuesin që të dallojë nxënësit, me prejardhje fshatare, nga ata të qytetit. Fëmija nga fshati, nga pamundësia që ka pasur për kontakte me mjedisin dhe botën rreth vetes, ndjehet inferior ndaj atyre të qytetit, dhe shfaq mëngësi të dukshme njohje, komunikim dhe sjellje. Qelizat e tij nervore, nuk e kanë njohur një program të tillë, dhe për rrjedhojë, nuk e kanë regjistruar.

Shpesh ndodhë që prindët, ju luten fëmive të tyre për t'i ndihmuar diçka në kompiuter. Prindët e kanë të vështirë që ta mësojnë kompiutrin, kanë vdekur qelizat për një gjë të tillë. Ndërkohë që fëmijët e moshës katër apo pesë vjeç bëjnë mrekulira në telefonin e dorës, gjyshi, zor se mund ta përdorë, telefonin e thjeshtë, për t'u përgjigjur dhe thirrur.

Fëmijët, nga moshja dy deri në gjashtë vjeç, mund të mësojnë njëkohësisht, minimumi tri gjuhë të ndryshme, pa u lodhur fare. Të rriturit nuk e kanë këtë aftësi, kanë vdekur qelizat e përshtatshme për këtë gjë.

Truri është një “vrasës” i pamëshirshëm i vetëvetes, i qelizave të panevojshme dhe nuk i riprodhon më ato.

Është detyrë e posaçme por dhe shumë e vështirë e prindërve që, gjatë kësaj periudhe, t'i aktivizojnë fëmijët e tyre me aktivitete të ndryshme, duke i nxitur dhe guximuar ata, për të qënë sa më aktivë dhe të shumanshëm, para se të vendosë truri për “ekzekutimin” e miliona qelizave “parazite”.

Mekanizmi i ndjenjave tek të rinjtë është ndryshej nga ai i të rriturve. Men-

pjesës frontale të trurit është të menduarit llogjik, vendi i ekuilibrit të ndjenjave me vetëkontrollin. Amygdala kontrollon, mbi të gjitha, sjelljet instiktive të individit, shpejtësinë e reaksioneve, atyre që e vënë njeriun në veprim në raste rreziku, pa pasur nevojë të mendojë.

Truri i mesëm është qëndra e ndjenjave të jetës dhe e arrinë zhvillimin e plotë në moshën 22 vjeç.

Shkenctarët e trurit, thonë se, të rinjtë, reagojnë para se të mendojnë, ndërkohë që të rriturit e kanë aftësinë e të menduarit para se të reagojnë. Kjo vërteton faktin që, përse të rinjtë janë aq të ndikuar në vendimmarrjet e tyre nga ndjenjat, duke na befasuar me surprizat e tyre.

Për të rriturit, në rastet e veprimeve të nxituara dhe të gabuara të të rinjve, është normale pyetja: Si e bëre ti këtë gjë? Por, po aq normale është edhe përgjigjia e të rinjve: Nuk e di! Ata vërtetë nuk e dinë. Të rinjtë mendojnë ndryshej, madje shumë më ndryshej nga të rriturit, në një mënyrë dhe art krejt tjetër, befasues. Amygdala reagon automatikisht, para se i riu të mund të timonojë situatën, për të vendosur, gjykuar apo kontrolluar diçka.



dohet se akoma nuk ka përfunduar së ndërtuari. Ndjenja e frikës, guximit, zemrimit, rebelizmit, përgjegjesisë, janë në një masë krejt tjetër nga ato tek të rriturit. Reagimet e tyre janë ndryshej nga ato që presin të rriturit.

Ndërkohë që të rriturit i analizojnë ndjenjat me pjesën frontale të trurit, aty ku është “busulla sociale”, të rinjtë i përceptojnë ato me amygdalën. Detyra e

Armiku më i rrezikshëm për të rinjtë, gjatë gjithë kohës së zhvillimit të trurit, deri në formimin e tij të plotë, janë lëndët helmuese, alkoholi dhe droga. Nëse të rinjtë, gjatë kësaj periudhe, konsumojnë në mënyrë të pakontrolluar drogë dhe alkohol, rrezikshmëria e dëmtimeve të pariparueshme të trurit, është shumë më e lartë se tek të rriturit. Rreziku tjetër i madh është se, sa më shpejt që të rinjtë

fillojnë me konsumin e drogës dhe alkoholit, aq më aktual është rreziku për të kaluar në vartësinë e tyre.

Fillimisht, droga dhe alkoholi godasin qendrën e “busullës sociale”, ku perceptohet bota, vjen mendimi llogjik dhe kontrollohen fjala dhe veprimet. Prandaj, i dehri mendon se mund ta drejtojë makinën dhe i droguari thotë se shkolla është kohë e humbur. Përceptime jashtë realitetit. Kjo tregon se është demtuar pjesa frontale e trurit, vendndodhja e ndjenjave. Shpesh qëllimi i drogë dhe alkoholpërdoruesve është demtimi i kësaj pjese të trurit. Në rastet kur kjo preket rëndë, njeriu humbë ritmin e frymëmarrjes, zemëra fillon të rrahë jashtë normave dhe mund të ndodhë edhe vdekja.

Nëse njeriu e ndërpret konsumin e drogës dhe alkoholit, fillon shërimi “brëndshëm” i trurit. Në fillim normalizohen funksionet automatike: zemëra dhe frymëmarrja, gjumi dhe oreksi. Pastaj rikthehen ndjenjat por, jo aq shpejt në masën normale. Madje tek disa zgjatë aq shumë sa nuk e durojnë dot dhe rikthehen përseri tek alkoholi dhe droga. Për shumë të rinj të cilët nuk e përballojnë dot kohëzgjatjen e rikthimit të ndjenjave, është mirë që të shkëputen nga mjedisi “helmues” dhe të dërgohen në vatra të sigurta, pa drogë dhe alkohol. Kështu që u hiqet mundësia e vendimmarrjeve jashtë kontrollit të ndjenjave.

Si rregull, trurit deri në shërimin e plotë, i duhet gjysma e kohës që përdoruesi ka konsumuar drogë apo alkohol.

Nëse ai ka konsumuar të tilla lëndë për dy vjet, truri i duhet një vit.

Në të gjitha rastet, përdorimi i dhunës dhe keqsjellja me viktimën e alkoholit dhe drogës, janë të pasuksesshme dhe madje të demshme. Duhet kërkuar ndihma e mjekut


Leke Imeraj

PROFESOR. AHMET OSJA – 24 SHKURT 2020

Në një familje me origjinë nga Reçi, më 25 Qershor të vitit 1939, në fshatin Luarz u lind Ahmet OSJA, ai që më vonë do të ishte i njohur në çdo skaj të Shqipërisë e më gjerë. Bir i një familje me tradita shumë patriotike dhe tipare të tjera të larta, do të bëhej “Profesor i Shkencave Bujqësore”, ka merrtur Urëdhin “Mjeshtër i Madh”, akorduar në vitin 2009 nga Presidenti i Republikës së Shqipërisë, “2000, Outstanding scholars of the 20-th Century”, IBC, Cambridge CB2 3QP, England; 2009, 2009 - Këshilli Bashkiak i Shkodrës e ka shpallur Profesorin Ahmet Osja «Mirënjohja e Qytetit»; 2009 - Forumi i Intelktualëve Shqiptarë, e vlerësoi si: “Intelktual i shquar - Emblemë e qytetarisë”, me njohuri të gjithanshme në shumë fusha të shkencës e kulturës dhe një personalitet i historisë shqiptare; 2010 – Anëtar nderi i Akademisë së Shkencave, ishte titulli që Akademia i akordoi ciceronit të bujqësisë, “Qytetar Nderi” i Bashkisë Malesia e Madhe, “President Nderi” i Shoqatës Shqiptare të Gazetarëve të Bujqësisë, “Anëtar Nderi” i shoqatës “Dukagjini”, si dhe ka një sërë vlerësimesh të tjera lokale dhe kombëtare.

Jetën profesionale, Ahmeti e filloi në zonën e Dukagjinit të Shkodrës, e pas kësaj përvoja mjaft interesante, ai u caktua të punonte pranë Stacionit të Zooteknikës në Shkodër, ku u mor me sektorin e kërkimeve për bimën e misrit. Më pas, për afro 30 vjet, ai punoi si ekspert dhe pastaj edhe drejtues në Institutin e Misrit dhe Orizit. Si koleg i afërt i Akademikut dhe shkencëtarit Hysen Laçej, njihet për rolin e çmuar në krijimin e hibrideve të rinj të misrit, si dhe evoluimin e teknologjisë së kultivimit të misrit në kushtet e Shqipërisë.

Në periudhën 1982 - 1991, për rreth 9 vjet, Ahmeti përfaqësoi rajonin si deputet në Kuvendin e Shqipërisë, ku u shqua për fjalime realiste dhe mjaft nxitëse për zhvillimin e zonës dhe të sektorit të bujqësisë. Për rreth 5 vite, ai ka qenë Kryetar i Komisionit të Bujqësisë në Parlamentin Shqiptar. Profesor Ahmet



Osja ka qenë edhe Ministër i Bujqësisë në vitin e vështirë 1991, si dhe lektor në Universitetin e Shkodrës dhe në Institutin e Lartë Bujqësor (UBT), në Kamëz, Tiranë.

Si studiues poliedrik, ai ka marrë pjesë në një sërë takimesh e konferencash kombëtare e ndërkombëtare, ku ka përfaqësuar e mbrojtur si radhëkush tjetër interesat e vendit të tij.

Profesor Osja zotëronte dije enciklopedike në shumë sfera të jetës si: arti, kultura, historia, ekonomia, legjislacioni, albanologjia dhe antropologjia, falë përvojës së gjatë në njohjen e territorit, bashkëkombësve dhe pasurive të vendit të tij, aq sa edhe të dëshirës së tij të madhe për të qenë pjesë e “lidhur” kombit dhe kontribues në prosperitetin e vendit.

Gjatë viteve të punës në IMO, është kontribuesi kryesor në mbledhjen, dokumentimin, shumëzimin dhe karakterizimin shkencor të një popullate prej 300 llojeve të misrave të vendit. Ndërkohë që puna këshillimore, divulgative dhe “rendja” pas fatit të hibrideve të misrit “Rozafa...”, të

krijua në IMO dhe të shpërndara në të gjithë Shqipërinë, ka qenë një kontribut me shumë vlerë në përmirësimin e rendimenteve dhe të cilësisë së miritit të mbjellura në rreth 75 mijë hektarë.

Në lidhje me veprën studimore dhe publicistike, Profesor Osja është autor dhe bashkautor i 17 botimeve në lëmin e bujqësisë shqiptare me kolegët e tij. Ka qenë anëtar i kolegjeve të redaksisë të Revistës “Shkenca dhe Jeta”, dhe i këshillit botues të revistës “Tribuna e Ekspertit”, në Këshillin Botues të “Kurora e Gjelbër”, etj. Ka realizuar një seri shkrimesh të vijueshme në gazeta qendrore e lokale, ka botuar mbi 350 të tillë, si divulgativë ashtu edhe shkencorë në revista dhe periodikë të ndryshëm. Ka nxitur dhe ka organizuar ngritjen e “Kopshtit të Paqes”, festën e “Luleve” në Shkodër e një sërë aktiviteteve të tjera unike.

Me ndarjen nga jeta të Profesor Ahmet Osja, u shua edhe rindasi i fundit, pasi ai ishte një institucion, ishte një enciklopedi, ishte dhe mbetet mësuesi, bashkëpunëtori i disa brezave të specialistëve, dhe miku i shumë e shumë njerëzve në të gjithë

Shqipërinë.

Amaneti i tij, që do të përjetësohet në pllakën e tij të varrit është:

Shqipërinë e bëjnë shqiptarët:

Shqipërinë nuk e bëjnë as të majtët, as të djathtët, por shqiptarët!

Shqipërinë nuk e bëjnë as jugu, as veriu, por shqiptarët!

Shqipërinë nuk e bëjnë as muslimanët, as ortodoksët, as katolikët, por shqiptarët!

Shqipërinë nuk e bëjnë as fshatarët, as qytetarët, por shqiptarët!

Shqipërinë nuk e bëjnë as të shkolluarit, as të pashkolluarit, por shqiptarët!

Shqipëria është një fidan që kërkon të mbillet në zemër, të ushqehet me shpirt dhe të drejtohet me mend: vetëm atëherë merr kuptim ky vend!

Të qoftë dheu i lehtë i dashtuni ynë Ahmet OSJA! I paharruar qoftë kujtimi Yt! Ngushëllime të sinqerta familjes!

Prof. dr. Zef Gjeta

KURIOZITET

A E DINI SE CILA KA QENË KAFSHA E PARË QË KA ECUR MBI TOKË? BËHET ZBULIMI I MADH

Cila ishte kafsha e parë që shëtiste në Tokë dhe merrte frymë me oksigjen atmosferik, duke nisur daljen nga oqeanet

dhe kolonizimin e planetit? Përgjigjja është te një fosil që ka qenë mbyllur për 35 vjet në një sirtar në Muzeun e Gjeologjisë të Universitetit të Wisconsin-it, i rizbuluar së fundmi nga paleontologu Otterbein Andreë Eëndruff, i cili botoi studimin e tij.

Kafsha, e cila quhet *Parioscorpio venator*, është një akrep i vogël pak më shumë se 2 centimetra i gjatë, që jetuar gjatë periudhës Silurianit, 437 milionë vjet më parë, në Wisconsin-in e sotëm. Anatomia

e tij sugjeron që ishte një kafshë e aftë të jetonte si nën ujë ashtu edhe në ajër të hapur.

Fosili i *Parioscorpio* (në të vërtetë, fosilet, pasi që janë gjetur dy) është veçanërisht interesant, sepse ka karakteristika hibride, mes paraardhësve të tij ujorë dhe pasardhësve tokësorë. Nga e para, për shembull, kafsha merr sytë, të vendosur përpara, si butakët modernë. Me këta të fundit ka të përbashkët praninë e një qelbi dhe, mbi të gjitha, një seri tubash që lidhin sistemi i tij të qarkullimit të gjakut me sistemin e frymëmarrjes, një tregues i aftësisë së tij për të absorbuar oksigjenin nga ajri, i quajtur ndryshe “frymëmarrja në tokë”. Të njëjtat struktura, shpjegon Wendruff, gjenden në një artropod tjetër primitiv, gaforren me patkua, i cili gjithashtu ndodh të jetë i aftë për jetën amfibe.

– Një papagall me Puck, renditet në Librin e Rekordëve Botërore Guinness si “Zogu me fjalorin më të madh në botë”. Ai është në gjendje të artikulojë 1728 fjalë në anglisht. Ai jo vetëm imiton, por krijon shpesh fraza dhe fjali të tijat.

– Më 1 korrik 1916, në Betejën e Somës në Francë, një sasi eksplozivi prej gati 30 mijë kg eksploziv shpërtheu, duke krijuar një krater 300 metra të gjerë dhe 90 metra të thellë. Shpërthimi, u dëgjua deri në Londër, dhe ishte më i zhurmshmi i kryer nga njeriu në histori deri në atë moment.

– Sytë më komplekse në të gjithë mbretërinë e kafshëve i përkasin karkalecit mantis, që mund të manipulojë polarizimin e dritës, gjatë gjithë spektrit të saj të dukshëm. Kjo është të paktën 10 herë ngjyra më shumë se sa spektri ynë i dukshëm.



RECETË PA KOMB - PËRKTHIM NGA SAIMIR LOHJA

Më 2 Dhjetor 1943, në gazetën KOMBI, shkollari perëndimor dhe njëkohësisht Kryetari i Kuvendit Kombëtar të Shqipërisë, Mihal Zallari, botoi shkrimin "Universalizmi dhe Nacionalizmi". Në të, ai shpaloste ortekun që po i derdhej Shqipërisë e tan shqiptarëve nga Lindja sllave. Midis të tjerave në shkrimin e tij kumbonte se "Komunizmi, një tjetër formë e universalizmit, thotë: Hiq dore nga vëllau tënd i gjakut dhe unë të bëj vëlla me të gjithë njerëzit e kësaj bote".

Ndërsa më 23 Maj 1944 në fshatin Suhadoll të Dibrës, Islam Elez Ndreu, djali i Cen Elez Ndreut nga Dibra, i shprehej oficerëve britanikë Julian Amery dhe Neil Billy McLean: "Siç e dini, tre parti politike janë në Shqipëri: agjentët e Gjermanisë, agjentët e Rusisë dhe agjentët e Anglisë. Ajo është e kuptueshme, por ajo që asnjëri nga ne nuk e kupton është se përse agjentët e Rusisë paguhen me ar anglez". Këtë e shkruan Julian Amery në librin e tij "Sons of the Eagle: A Study in Guerilla War, London Macmillan & Co. Ltd., 1948", faqe 137-138.

Oficerët e spiunazhit britanik nuk ia kthyen përgjigjen; nuk ishte ai qëllimi i ardhjes së tyre në Shqipëri. Shqiptarët para, gjatë e pas Luftës II Botërore nuk patën mundësi t'i njihnin regjisorët perandorakë që krijuan teatrin shqiptar në shekullin XX. Edhe pikëpyetja e përbaljes së nacionalizmit me ortekun e universalizmit edhe pyetja e Majit 1944 mbetën pa përgjigje derisa u paraqit në vitin 2018 libri në Shqip RECETA PA KOMB dhe forma e tij në anglisht THE NATION-FREE RECIPE.

Këto më sipër janë vetëm dy grimca nga ky libër. Në këtë libër ai që di shumë gjen vetveten dhe ai që di më pak do dijë shumë më shumë. Brendia e tij ka përmbajtje ndryshe nga një hartë mendore e zakonshme. Në çdo rast brendia e librit sfidon kuptimin e gjithsecilit për çka ka ndodhur me shqiptarët që nga fillimi i shekullit XX e deri në ditët e sotme dhe pse. Bie fjala, nëse Lidhja Entente do kishte patur autoritet të plotë nuk do ishte njohur as principata shqiptare më 9 Korrik 1913.


Libri mbulon Europën dhe përqendrohet në Gadishullin Ilirik. Brendia e tij zbërthen çfarë ndodhi në Europë gjatë shekullit XX dhe pse. Libri nuk jep atë që propaganda e Lidhjes Entente në Lindje e Perëndim e ka futur në qarkullim të hapur nëpër libra dhe internet. Për kureshtje vetëm disa pyetje që prekin përgjigjet e munguara janë më poshtë:

- Loja me fjalët anglisht – albanisht - shqip
- Çfarë ishte Lufta I Botërore dhe



- Lufta II Botërore?
- Tre Jugosllavitë e shekullit XX, prej kujt dhe pse?
- Lufta e shenjtë sllave (Svyashchennaya Voyna) ose Xhihadit Sllav...
- Shiu i monedhave prej ari dhe ndihmave ushtarake e ushqimore, ku dhe pse?
- Trojet shqiptare të tradhtuara, si e nga cilët?
- Masakrat...përse?
- Pse numri i 28'000 "dëshmorëve"?
- Piratimi i qindra ton ar nga Shqipëria, si, kur, kush, ku?
- Çfarë ishin Gardhimi - Liridhënia - Titizmi?
- "Divers ants" e riatdhesuar, pse?
- Rënia në mina në Kanalin e Korfuzit më 1946, pse, kush, si?
- Rrëfenja gjysmake për spiunët britanikë të Kembrixhit...
- Çfarë ishte e ashtuquajtura Perdja e Hekurt e Luftës së Ftohtë dhe zgjatim i kujt ishte?
- Pse Shqipëria e krasitur u mbyll në kafaz për 45 vjet dhe vitet pas 1991 kanë qenë ato që kanë qenë?

Aty lexohet ajo që nuk ishte menduar më parë. Libri nuk është opinion vetjak dhe aty janë të gjitha fjetet të endura e të lidhura që nga fillimi i shekullit XX. Ato që e kanë lexuar librin kanë përparuar shumë dhe u japin buzëqeshje lajmeve apo shkrimeve që lexohen në internet,



gazeta dhe libra. Libri kërkon mendje të fortë dhe lexues mendje hapur. Libri lexohet shpejt, brenda dy ditëve, dhe rilexohet më pas pa vonesë. Kështu kanë vepruar lexuesit dhe disa shënime të tyre pasojnë:

Ky libër është për pasi të kalojnë edhe 20 vjet. (L.K.)

Paskam qenë duke lexuar në errësi deri më tani. (Xh. G.)

Tani librat që kam në bibliotekë vlejnë për fabrikë letre. (D.H.)

Tani jam më i prapambetur. (D.L.)

Ky libër më ndezi llambat në mendje. (A.D.)

Këtë libër më duket se e kam shkrojtur vetë. (B.K.)

Saimir A. Lolja, *The Nation-Free Recipe*
The war of communists for "liberation" was a fight for reoccupation... from the Anglo-Soviet Entente, Tellwell, Vancouver, 2018.

www.amazon.com
www.bookdepository.com
www.abebooks.com

Saimir A. Lolja, *Receta pa Komb*
Lufta e sllavo-komunistëve për "çlirim" ishte një luftim për ripushtim...prej marrëveshjes Entente Anglo-Sovjetike, Sh. B. Helga's Secrets, Tiranë, 2018.

Libraritë:
Adrion, Libri Universitar, Albania (Tiranë); Erblin (Elbasan), Buzuku (Prishtinë), Alfabeti (Gjilan), www.bukinist.al

KUR DO TË VENDROSEN NË VENDIN QË U TAKON TRE FIGURAT KOMBËTARE, BOGDANI, GJEÇOVI DHE ZOGAJ?

Sivjet është 330 vjetori i vdekjes së Pjetër Bogdanit, 240 vjetori vdekjes së Don Pal Zogajt dhe 90 vjetori i vrasjes së Shtjefën Gjeçovit, tre personalitete me kontribute shumë të mëdha në nivel kombëtar.

Pjetër Bogdani qysh kur botoi veprën e parë të njohur në gjuhën shqipe është krahasuar nga bashkohësit e tij me heroin tonë kombëtar Gjergj Kastriotin Skënderbeu. Vepra e tij tashmë është studiuar dhe publikuar nga institucionet shkencore më të larta në Shqipëri dhe në Kosovë. Ajo është e njohur në Shqipëri dhe në tërë botën.


Pjetër Bogdanit i njifet edhe kontributi në luftën Austro Turke të viteve 1686-1689 përkrah forcave të Pikolominit, pra përveçse si shkrimtar, ka kontribute edhe në luftën për çlirim kombëtar. Deri më sot nuk i është dedikuar asnjë titull nderi.

Dom Pal Zogaj, nga fshati Zogaj, në vitin 1776, ka shkruar gramatikën e gjuhës shqipe, e cila është e dyta mbas asaj të shkruar nga Andrea Bogdani e cila konsiderohet e humbur. Këto dy gramatika janë të parat të hartuara nga autorë shqiptar në tërë historinë e gjuhës shqipe për 2000 vjet. Instituti Albanologjik



i Kosovës dhe Profesi i nderuar Zymer Neziri, me kohë e kanë ngritur problemin për vlerësimin e kësaj figure me rëndësi për gjuhën dhe kulturën shqiptare, por deri më sot asnjë titull nuk i është dhënë.

Shtjefën Gjeçovi, i njohur botërisht si themeluesi i Arkeologjisë Shqiptare, shkrimtar, humanist, etnograf, autori i Kanunit të Lek Dukagjinit, vepër e cila ka njohur dhjetëra botime dhe është e publikuar në pesë gjuhë të botës, ka vetëm një dekoratë që i është dhënë në vitin 1962, me rastin e 50 vjetorit të shpalljes së



pavarësisë së Shqipërisë. Me atë rast ai është vlerësuar me Urdhërin e Punës të Klasit të Tretë. Qeveria e asaj kohe, nuk ka begenisur t'i jepte së paku Urdhërin e Punës të Klasit të parë.

Pushka e Shtjefën Gjeçovit është e vendosur në Muzeun Historik Kombëtar qysh në vitin 1970. Gjeçovi edhe pse ishte klerik dhe studjues i përmasave ndërkombëtare, mbajti lidhje me Bajram Currin, Dom Nikoll Kaçorrin dhe figura të tjera të rëndësishme të rilindjes tonë kombëtare duke u radhitur me pushkë në dorë për lirinë dhe pavarësinë Shqipërisë.

Është në nderin e intelektualëve nga Prefektura e Kukësit dhe të organeve të pushtetit vendor që t'i propozojnë Presidentit të Republikës, Shkëlqesisë së tij Z. Ilir Meta, që të vlerësohen sipas kontributeve që kanë dhënë, me titujt e nderit më të larta të shtetit shqiptar.

Ju bëj thirrje këtyre institucioneve që me rastin e vendosjes së shtatores së Pjetër Bogdanit në qytetin e Krumës, të nderohen të tre këta kollosë të mendimit intelektual shqiptar me dekoratat më të larta.

Mark Palnikaj,
Tiranë më 24 janar 2020

NJOFTIM

Për të gjithë ata që janë të interesuar për gazetën Dukagjini, në Tiranë, u njoftojmë se ajo gjendet në Bibliotekën Kombëtare, koleksioni i të gjithë numrave të botuar, si dhe në pikën e shitjes të gazetave pranë Teatrit të Kukullave. Për informacion te mëtejshëm mund të kontaktoni në nr. tel. 0692795033. Faleminderit!

KRITERET E REDAKSISË DHE NORMAT PËR PUBLIKIM NË GAZETËN E SHOQATËS "DUKAGJINI"

Artikujt e dërguar fillimisht do të vlerësohen nga redaksia. Vlerësimi nga stafi redaktues është i drejtuar për të konstatuar nëse artikujt e dërguar janë tematikisht përkatës për gazetën, në përputhje me kodin dhe linjën e redaksisë. Gjithashtu, **kontribuesi/kontribuesit që dërgon/dërgojnë artikullin duhet që të respektojnë etikën e të shkruarit. Ndalohen respektivisht publikimi i artikujve që përmbajnë fjalor joetik dhe janë dukshëm të papërshtatshëm nga pikëpamja e një publikimi në gazetë.**

Në rast të refuzimit, autori do të infor-

mohet menjëherë me e-mail - brenda 48 orëve - nga redaksia dhe vendimi do të jetë i motivuar në mënyrë sintetike. Kontribuesi nuk duhet kurrsesi ta marrë si personale refuzimin e publikimit të gazetës.

Në raste të tjera, kur një artikull përmban vetëm ndonjë një përqindje të ulët (fjalë tek tuk) të përdorimit të fjalëve joetike, atëherë redaksisë i lind e drejta që të parashtrijë sugjerime për ndryshimin e tyre duke i zëvendësuar me fjalë që mund të përcojnë kuptimin që kontribuesi ka synuar të transmetojë tek lexuesit. Pra, artikulli mund të publikohet vetëm pas rishikimeve të tilla.

Pra, përmbledhtazi stafi redaktues do t'i kthejë mbrapsht artikujt tek autori/ët që nuk është/ janë përshtatur me rregullat. Në rast të mospërputhjes së autorit, redaksia rezervon të drejtën ekskluzive të refuzojë botimin e artikullit.

Autorit/autorëve kontribues i/u kërkohet gjithashtu të përshtasë/tin artikullin në standardet e treguara më poshtë.

Artikujt të shkruhen në gjuhën shqipe letrare dhe duhet të dërgohen në adresat e mëposhtme: nduesanaj@yahoo.it, sundoprospe@gmail.com ndërmjet datave

15-20 të muajit përkatës. Çdo artikull që dërgohet pas datës përfundimtare, nuk do të merret në shqyrtim për tu botuar.

FORMATI I ARTIKULLIT

TITULLI- Titulli i artikullit duhet të jetë i vetëm dhe mbi të gjitha i shkurtër dhe informativ, por domethënës që ka lidhje me brendësinë e artikullit. Gjithashtu duhet të shkruhet me SHKRONJA SHTYPI.

PËRMBAJTJA- Le të kujtojmë, për sa mund të jetë e dukshme, që në çdo rast, teksti i propozuar duhet të shkruhet në mënyrë të qartë dhe të kuptueshme, qëllimi i artikullit dhe përmbajtja e përshkruar duhet të jenë të qarta. Sa më shumë që materialet të dërgohen në tekst të thjeshtë, pa formate të çuditshme dhe më pak gabime aq më i mundur do të bëhet redaktimi përfundimtar.

FORMATI I ARTIKULLIT- artikulli duhet që të dërgohet në Word.

SHKRIMI -Shkrimi të jetë me hapësira 1 dhe pa hapësira të ndërmjetme. Shkrimi duhet të jetë në "Times New Roman".

GJATËSIA E ARTIKULLIT - Jo më

shumë sesa 1 faqe format A4 dhe ½. Në raste të veçanta në varësi të tematikës, mund të pranohen 2 faqe format por artikujt shumë të gjatë nuk pranohen. Në raste specifike, artikulli do të ndahet në dy pjesë (pra do vijojë numrin vijues të gazetës)

BIBLIOGRAFIA- Duhet të shënohet bibliografia e rregullt nëse i referoheni si citim autorëve të huaj

KORREKTIMI -Autorëve të artikujve të pranuar për publikim do tu kërkohet që të korrigjojnë artikujt që dërgojnë të cilat duhet të kthehen brenda pesë ditëve. Nuk lejohet futja e ndryshimeve thelbësore në artikullin e dërguar më përpara.

TË TJERA - Autori mban përgjegjësi për përmbajtjen e artikullit. Duhet të dërgojë një foto personale dhe adresën e kontaktit elektronik. Materiali i dërguar duhet të shoqërohet me foto të aktivitetit përkatës duke përzgjedhur 2-3 foto kryesore. Autori mund të dërgojë 1-2 artikuj për numër gazete të cilat vlerësohen më pas vlerësohen nga redaksia se cili prej tyre mund të përbëjë prioritet ose që mund të botohen të dy artikujt.

REDAKSIA

Kryeredaktore: Suela Ndoja
Redaktorë: Luigj Shyti, Lazër Stani, Roza Pjetri, Prelë Milani, Lazër Kodra, Zef Nika, Zef Gjeta, Lulash Brigja, Kole Çardaku, Eilda Delija, Age Martini, Klodiana Serraj, Vilson Peshkaj, Marijan Ndershtiqaj, Arber Shytani, Zef Bari, Gjon Fierza e Ndue Ziçi.

Mundësoi Botimin:
KUJTIM FUNIÇI

